



DREJTËSIA

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DREJTËSIA

UDHËZUES PËR INTEGRIMIN GJINOR



UN WOMEN SHQIPËRI

2023

Ky publikim është përgatitur nga UN Women Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri - Zbatimi i *acquis* të BE-së për Barazinë Gjinore” (EU4GE), që zbatohet nga UN Women dhe UNFPA dhe financohet nga Bashkimi Evropian përmes Fondit të Përsheptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autoreve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara apo ndonjë prej organizatave të lidhura me to.

Autoret: Agustela Nini-Pavli, Ani Plaku, Katherine Belen, Dolly Wittberger

Përkthimi: Majlinda Nishku

Redaktimi: Majlinda Nishku, Monika Kocaqi

Faqosje dhe grafika: Erald Lamja

PASQYRA E LËNDËS

Shkurtesa dhe akronime	4
Hyrje	6
1. Drejtësia – çështjet gjinore kryesore në Shqipëri	9
2. Barazia gjinore dhe drejtësia në kontekstin e anëtarësimit në BE	26
3. Lidhja e drejtësisë me <i>acquis</i> e BE-së për barazinë gjinore	31
3.1. Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit përkatës	34
3.2. Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas 'Rregulloreve të NDICI-it'	43
3.3. Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC	43
4. Mjetet kryesore për integrimin gjinor	48
4.1. Analiza gjinore	48
4.2. Statistikat gjinore mbi drejtësinë në kontekstin shqiptar	49
4.3. Vlerësimi i ndikimit gjinor	51
4.4. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në sektorin e drejtësisë	52
4.5. Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor	54
4.6. Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor	55
5. Rekomandime të rëndësishme në sektorin e drejtësisë	56

LISTA E FIGURAVE, KUTIVE DHE TABELAVE

Figura 1: Përvojat e dhunës në familje të vetëdeklaruar nga gratë krahasuar me numrin e rasteve të raportuara në polici, 2018	11
Kutia 1: Treguesit kryesorë të fushës përkatëse të politikave të BE-së për të cilat ka të dhëna të disponueshme në Shqipëri	18
Kutia 2: Treguesit specifikë kryesorë të BE-së mbi aksesin në drejtësi	20
Kutia 3: Treguesit kryesorë të BE-së për fushën përkatëse të politikave, që është e mundur të llogariten në Shqipëri	24
Kutia 4: Përmbledhje e problemeve kryesore të pabarazisë gjinore në sektorin e drejtësisë në Shqipëri	25
Tabela 1: Shembuj të mangësive gjinore në sistemin e drejtësisë	29
Tabela 2: Përafrimi i Kapitullit 23 me treguesit e GAP III të BE-së	37
Tabela 3: Kërkesat minimale për përmbushjen e kriterëve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të OECD-DAC	45
Tabela 4: Veprime prioritare për integrimin e objektivave të barazisë gjinore në sektorin e drejtësisë	57

SHKURTESA DHE AKRONIME

AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
BE	Bashkimi Evropian
BPfA	Platforma për Veprim e Pekinit
BPGJ	Buxhetim i Përgjigjshëm Gjnor
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
COVID-19	Sindroma e rëndë akute e rrugëve të frymëmarrjes shkaktuar nga koronavirus 2 (SARS-CoV-2)
CRPD	Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
DHBJ	Dhuna me Bazë Gjnore
DHF	Dhuna në Familje (dhuna në marrëdhëniet familjare)
DHSBJ	Dhuna Seksuale dhe me Bazë Gjnore
EIGE	Instituti Evropian për Barazinë Gjnore
EU4GE	BE për Barazinë Gjnore
GAP	Plani i Veprimit për Barazinë Gjnore (i BE-së)
GENDERNET	Rrjeti për Barazi Gjnore i Komitetit të Ndhmës për Zhvillim, i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD DAC)
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GREVIO	Grupi i Eksperteve/Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimi
NDICI	Instrumenti i Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KE	Komisioni Evropian
KM	Këshilli i Ministrave
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KR-BE	Korniza e Rezultateve e BE-së
KR-IPJ	Korniza e Rezultateve e Instrumenteve të Politikës së Jashtme (të BE-së)

Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
LGBTI+	Persona lezbike, gej, biseksualë/e, transgjitorë/e, transseksualë/e, interseks dhe cilëtdo persona të tjerë orientimi seksual, shprehja e identitetit gjinor dhe/ose karakteristikat e seksit të të cilëve/ave janë të ndryshme nga heteroseksualët/et
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
NJF	Ndihma Juridike Falas
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OECD-DAC	Komiteti i Ndhmës për Zhvillim i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PPPGJ	Prokurim Publik i Përgjigjshëm Gjinor
SANECA	Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit të Shqipërisë për Kapitujt Ekonomikë të Acquis
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
TBE	Traktat i Bashkimit Evropian
TFBE	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UMPMM	Urdhër për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme
UN	Kombet e Bashkuara
UNCT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Vendin
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNSCR	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UPR	Rishikimi Periodik Universal
VNRR	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator

HYRJE

Ky udhëzues për integrimin gjinor është pjesë e një vargu materialesh burimore që i janë vënë në dispozicion qeverisë së Shqipërisë përmes ndihmës teknike të BE-së dhe UN Women, me qëllim përshtetimin e procesit të integritit në BE. Qëllimi i tij është të sigurojë që dokumentet e ardhshme të politikave, planifikimit dhe programimit të përafrohen ngushtë me kuadrin ligjor dhe të politikave të BE-së për barazinë gjinore ('*acquis* për barazinë gjinore'), çka do të sjellë përmirësimin e rezultateve të barazisë për të gjitha/gjithë: gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në mbarë vendin. Ai u drejtohet partnerëve të zhvillimit dhe integritit të përfshirë në nisma të politikave, programimit dhe planifikimit, në kontekstin e anëtarësimit në BE. Në këtë grup përfshihen së pari nëpunëset/nëpunësit që formulojnë politikat dhe hartojnë programet e IPA-s, ekspertet/ekspertët që ofrojnë ndihmë teknike, drejtueset/drejtuesit e projekteve pranë Delegacionit të BE-së, donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit që mbështesin reformën e përafrimit me BE-në dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të angazhuara në proceset e llogaridhënies dhe konsultimit. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ofrojë informacion të përmbledhur mbi çështjet gjinore kryesore në një fushë të caktuar të politikave dhe të tregojë se si mund të realizohet integrimi gjinor në terma praktikë. Udhëzuesi është parashikuar si një material përgatitor për hedhjen e bazave në këtë drejtim. Ai mund të përdoret nga individët si dokument orientues në punën e tyre të përditshme dhe shërben si material trajnimi në përpjekjet për të krijuar kapacitete dhe aftësi për integrimin gjinor.

Barazia ndërmjet grave dhe burrave është një parim themelor i Bashkimit Evropian. E drejta e grave për trajtim të barabartë është, para së gjithash, një nga të drejtat themelore të njeriut. Legjislacioni i BE-së, e njeh diskriminimin si të papranueshëm politikisht, pa përfitim ekonomik, dhe të dënueshëm me ligj. Për këtë arsye, shteteve u kërkohet që të përmbushin kërkesat e *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Siç përcaktohet në legjislacionin e BE-së, strategjia për promovimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave dhe luftimin e diskriminimit është integrimi gjinor. Rrjedhimisht, integrimi gjinor është parakusht për përafrimin e standardeve kombëtare me parimet e BE-së dhe një element i pandashëm i proceseve vijuese të reformës.

Barazia gjinore mund të arrihet vetëm në një sistem qeverisjeje që mbështetet në shtetin e së drejtës, në themel të të cilit është mbrojtja e efektshme gjyqësore që kërkon pavarësinë, cilësinë dhe efikasitetin e sistemit kombëtar të drejtësisë, si dhe akses të barabartë në drejtësi për të gjitha/gjithë.

Aksesi në drejtësi është një nga të drejtat bazë të njeriut dhe, në të njëjtën kohë, një mjet përmes të cilit zbatohen të drejtat e të tjera të njeriut. Aksesi në drejtësi u bën të mundur individëve të mbrohen nga shkeljet e të drejtave të tyre, të vënë në vend padrejtësitë civile, t'i kërkojnë llogari pushtetit ekzekutiv dhe të mbrohen në procese penale. Ai është një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe përshkon të gjitha fushat e së drejtës: civile, penale dhe administrative.¹

Të drejtat sociale dhe ekonomike, të drejtat qytetare dhe fuqizimi i grave në shekullin e 21-të nuk mund të realizohen pa akses të barabartë të grave në drejtësi. Për të arritur që gratë dhe burrat të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre të njeriut, duhet që të gjenden zgjidhje dhe të reduktohen në mënyrë të efektshme pabarazitë gjinore për sa i përket aksesit në drejtësi.² Ky udhëzues për integrimin gjinor për sektorin e drejtësisë është i organizuar në pesë pjesë të shkurtra dhe synon të mbështesë aktorët e interesuar që:

- të kuptojnë problemet e pabarazisë gjinore në sektorin e drejtësisë;
- të njihen me rekomandimet e politikave dhe direktivat përkatëse të BE-së;
- të identifikojnë treguesit përkatës për integrimin gjinor në sektorin e drejtësisë;
- të njohin metodat dhe mjetet e standardizuara të BE-së për përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore;
- të angazhohen në veprimtari të mëtejshme konkrete, bazuar në një listë të përmbledhur rekomandimesh kryesore.

1 Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe Këshilli i Evropës (2016). *Handbook on European law relating to access to justice*. (Manual mbi të drejtën evropiane lidhur me aksesin në drejtësi). Shih: <https://fra.europa.eu/en/publication/2016/handbook-european-law-relating-access-justice>

2 Komisioni Evropian (pa datë). *Thematic Brief: Gender and Access to Justice*. (Dosje tematike: Gjinia dhe aksesin në drejtësi). Gjendet në: https://eugender.itcilo.org/toolkit/online/story_content/external_files/TA_Justice.pdf

Barazia gjinore nuk ka të bëjë vetëm me 'gratë'.

Përkundrazi, ajo ka të bëjë me realitetet dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave në të gjithë shoqërinë; dhe me pranimin që këto realitete dhe nevoja duhet të vlerësohen dhe – çka është e rëndësishme – të edukohen.

Për këtë është e nevojshme të sigurohet që të gjithë njerëzit të fuqizohen që të luajnë një rol të plotë dhe produktiv në familje, komunitet, shoqëri dhe ekonomi. Të jenë vetë zot të jetës së tyre, të bëjnë zgjedhjet që dëshirojnë dhe, për rrjedhojë, të kenë akses të drejtë dhe të barabartë në shërbime, mbështetje dhe në mundësi.

Prandaj, qeverisja e përgjigjshme gjinore ka të bëjë me sigurimin që, në të gjitha politikat, programet, aktivitetet, përparësitë dhe buxhetet e përgatitura prej saj, qeveria mban parasysh nevojat dhe shqetësimet e ndryshme të grave dhe burrave, si dhe trajton dhe redukton pabarazitë ndërmjet tyre.

Aksesi në drejtësi është “mundësia që njerëzit të kërkojnë dhe të gjejnë drejtësi përmes institucioneve formale dhe joformale të drejtësisë dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut”.³

Reformat në drejtësi janë të nevojshme në mbarë botën, për të korrigjuar ndikimin e marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit ndërmjet burrave dhe grave. Gratë nuk janë një grup i njëtrajtshëm. Shpesh kombinimi i disa karakteristikave personale me situatat rrethore çon në thellimin e përjashtimit dhe marginalizimit të tyre. Në rastet kur ka ndërthurje të dy ose më shumë faktorëve të përjashtimit, sikurse ndodh shpesh – për shembull në rastin e grave rurale, grave me aftësi të kufizuara, grave nga pakica etnike, gjuhësore ose pakica të tjera, grave nga komuniteti LGBTI+, etj. – rreziku i përjashtimit shoqëror dhe marginalizimit jo vetëm që vazhdon të ekzistojë, por ai edhe zë rrënjë dhe mund të zgjasë gjatë gjithë jetës e të përcillet nga brezi në brez.

Përshtatur nga: UN Women, UNDP, UNODC dhe OHCHR (2018). *A Practitioner's Toolkit on Women's Access to Justice Programming*. (Manual i Praktikanteve/Praktikantëve për Programimin e Aksesit të Grave në Drejtësi). Gjetet në: https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/PractitionerToolkit/WA2J_Introduction.pdf

3 UNDP (2016). *Human Development Report 2016: Human Development for Everyone*, pp. 198-201. (Raport i zhvillimit njerëzor 2016: zhvillim njerëzor për të gjithë, f. 198-201). Shih: <https://hdr.undp.org/content/human-development-report-2016>

1 DREJTËSIA – ÇËSHTJET GJINORE KRYESORE NË SHQIPËRI

Që nga viti 2016, Shqipëria ka filluar një proces të rëndësishëm të reformës në drejtësi, që synon ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas. Miratimi i ligjeve përkatëse dhe krijimi i një strukture koherente institucionale tashmë ka filluar të japë rezultate të prekshme.⁴

Megjithatë, pavarësisht nga përparimi i ndjeshëm në fushën e legjislacionit, që me gjasë do të sjellë rezultate më të mira për qytetaret/qytetarët shqiptarë/shqiptarë në fushën e drejtësisë, gratë ende përballen me vështirësi dhe sfida të mëdha në sistemin e drejtësisë, sikurse pasqyrohet edhe në shumë raporte të kohëve të fundit nga mekanizma të të drejtave të njeriut.⁵ Gratë nga komunitetet e pafavorizuara që përjetojnë forma të ndërthurura dhe të shumëfishta të diskriminimit për shkak të gjinisë dhe të faktorëve të tjerë shtesë (si gratë që jetojnë në zonat rurale, gratë e moshuara, gratë me aftësi të kufizuara, gratë lesbike/biseksuale/transgjinore, gratë e trafikuar dhe emigrante apo imigrante) rrezikojnë të përballen me barriera më të mëdha në aksesin e tyre në drejtësi. Kjo vjen për shkak të disavantazheve të caktuara në nivelin social-ekonomik, por mund të jetë edhe rezultat i mungesës së ndërgjegjësimit në radhët e punonjëseve/punonjësve të organeve të drejtësisë dhe atyre ligjzbatuese lidhur me nevojat e tyre. Gratë nga këto grupe shpesh janë edhe objekt i stereotipizimit, çka mund të bëhet shkas për trajtimin e tyre me njëanshmëri dhe mungesë ndjeshmërie nga sistemi i drejtësisë, dhe madje mund të çojë deri edhe në mohim të drejtësisë.

Në pjesën në vijim, paraqiten problemet kryesore që lidhen me çështjet gjinore në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, që duhet të trajtohen siç duhet në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Masat për parandalimin e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ), për mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të autorëve të dhunës, nuk zbatohen mjaftueshëm. Vitet e fundit, Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm në drejtësi të përafritit të kuadrit ligjor dhe të politikave të saj mbi DHBGJ-në, në përputhje me standardet ndërkombëtare.⁶ Megjithatë, në sistemin e drejtësisë

4 *EU for Justice Annual Action Plan in favour of Albania for 2021.* (BE për drejtësinë: Plani vjetor i veprimit në favor të Shqipërisë për vitin 2021). Shih https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2022-01/C_2021_9730_F1_ANNEX_EN_V1_PL_1674609.PDF

5 CEDAW (2016), GREVIO (2017), UPR (2019), CRPD (2019), etj.

6 Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së, etj.

duhet të përmirësohen disa aspekte për të siguruar reagimin e duhur ndaj dhunës me bazë gjinore:

- **Jo të gjitha format e DHBGJ-së pasqyrohen në legjislacion ose adresohen nga përgjigjja institucionale.** Kështu, ndërsa në Kodin Penal të Shqipërisë përndjekja, ngacmimi dhe dhuna seksuale përkufizohen si vepra penale⁷, masat e parandalimit dhe të mbrojtjes, si dhe aksesit në shërbime, shpesh nuk janë të disponueshme për gratë viktime të këtyre formave të dhunës.⁸ Për më tepër, legjislacioni penal shqiptar ende ka nevojë të harmonizohet plotësisht me standardet ndërkombëtare, veçanërisht për sa i përket përkufizimit të 'dhunës seksuale' dhe 'dhunës seksuale duke përfshirë përdhunimin', i cili vazhdon të bazohet në kriterin e përdorimit të forcës dhe jo në atë të dhënies së pëlqimit.⁹ Forma të tjera të DHBGJ-së si 'gjymtimi gjenital femëror' dhe 'sterilizimi i detyruar' gjithashtu duhet të përfshihen si vepra penale.¹⁰
- **Niveli i raportimit të dhunës vazhdon të jetë i ulët.** Sipas Vrojtimit Kombëtar mbi Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri të vitit 2018, dhuna ndaj grave dhe vajzave vazhdon të jetë shumë e përhapur: një ndër tri gra, ose 34 për qind e tyre, kishte përjetuar dhunë gjatë 12 muajve

7 Nenet 121/a, 108/a dhe 107/a (si dhe nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105 dhe 106) të Kodit Penal.

8 Një numër gjithnjë e më i madh studimesh konfirmon se dhuna në marrëdhëniet e dashurisë/dhuna ndaj të rejave/rinjve nga partneri intim përbën një problem shoqëror dhe të shëndetit publik i cili është shumë i rëndësishëm të luftohet. Një studim mbi dhunën në marrëdhëniet intime ndërmjet të rejave dhe të rinjve të moshës 16 deri 19 vjeç tregoi se 22 për qind e adoleshenteve/adoleshentëve kanë pasur një përvojë të tillë. Kjo lloj dhune u raportua më shumë nga vajzat adoleshente (28 për qind) dhe pak më pak nga djemtë adoleshentë (20 për qind). Një studim tjetër në rang kombëtar me të rejat dhe të rinjtë në Shqipëri konstatoi se pothuaj një nga dhjetë vajza të anketuara janë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale për herë të parë kundër vullnetit të tyre. Gratë kanë pothuaj tri herë më shumë gjasa se burrat që të jenë detyruar të kryejnë marrëdhënie seksuale për shkak të frikës nga partneri/ish-partneri. Dy nga tre personat e anketuar që kishin përjetuar dhunë thanë se nuk kishin kërkuar asnjë lloj ndihme për shkak të mungesës së besimit tek institucionet (policia dhe institucione të tjera), ndjenjës së turpfit dhe konfuzionit, si dhe frikës se mos njollosnin emrin e mirë të familjes. 12 për qind e vajzave dhe pesë për qind e djemve raportuan se ishin përdorur foto/video apo materiale të tjera me përmbajtje seksuale për t'u bërë shantazh. Burimi: AWEN, 2018. Dhuna në marrëdhëniet intime në adoleshencë në Shqipëri. Shih: https://www.researchgate.net/publication/351424581_DHUNA-NE-MARRREDHENIET-INTIME-NE-ADOLESHENCE-NE-SHQIPERI_2019; AWEN, 2021. Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rejat/rinj të në Shqipëri. Shih: <https://awenetwork.org/media/64620a967e68f.pdf>


9 Konventa e Stambollit dhe Rekomandimi i Përgjithshëm nr.35 i CEDAW.

10 Për përkufizimet shih Konventën e Stambollit, respektivisht nenet 38 dhe 39. Gjetend në: <https://rm.coe.int/168046246b>

para studimit.¹¹ Megjithatë, në vitin e kryerjes së vrojtimit (2018), numri i rasteve të raportuara në polici ishte vetëm 4.591.¹² Në vitin 2019, në polici u raportuan 4.629 raste; në vitin 2020, 4.701 raste; dhe 5.312 raste në vitin 2021.¹³ Pavarësisht nga një farë rritjeje në raportimet e rasteve të dhunës vitet e fundit, numri i rasteve të raportuara te autoritetet vazhdon të jetë shumë i ulët në krahasim me numrin faktik të grave që përjetojnë dhunë.¹⁴

FIGURA 1

Përvojat e dhunës në familje të vetëdeklaruar nga gratë krahasuar me numrin e rasteve të raportuara në polici, 2018



Burimi: Llogaritje të autoreve bazuar në: Anketën e DHF-së të INSTAT-it 2019¹⁵; të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të raportuara në botimin “Gra dhe burra në Shqipëri 2019”¹⁶; të dhënat e INSTAT-it për popullsinë¹⁷

11 Shih: <https://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf>

12 Të dhëna administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, dërguar Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare me shkresën nr. 185/1 të datës 31.01.2022.

13 *Po aty*.

14 Sipas të dhënave të INSTAT-it për popullsinë, në vitin 2018 numri i përgjithshëm i grave në grupmohën përkatëse (20-74 vjeç) në numrin e përgjithshëm të popullsisë ishte 1.008.533. Shih: <http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/>

15 Shih: <https://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf>

16 Shih: <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2019/women-and-men-in-albania-2019/>

17 Shih: <http://databaza.instat.gov.al/pxweb/en/DST/>

- **Numri i rasteve për të cilat janë pranuar kërkesat për urdhra mbrojtjeje (UM/UMM)¹⁸ është i ulët krahasuar me numrin e rasteve të raportuara.** Raporti midis masave mbrojtëse të kërkuara nga policia dhe numrit të përgjithshëm të rasteve të dhunës të raportuara në periudhën 2014 - 2021 varionte nga 53 deri 61 për qind.¹⁹ Po kaq i ulët ishte edhe numri faktik i kërkesave të pranuar nga gjykatat: nga viti 2014 deri në 2017, një numër i madh çështjes gjyqësore – rreth 60 për qind e proceseve për UM/UMM – u pushuan pa vendim të formës së prerë nga gjykata.²⁰ Edhe në vitet e fundit nuk është vënë re ndonjë ndryshim i madh: në vitin 2020 pati 4.702 raportime të dhunës në familje, në gjykatë u paraqitën 2.836 (60 për qind) kërkesa për masa mbrojtëse dhe në 1.596 raste (56 për qind) u miratuan masat mbrojtëse me urdhër gjykate.²¹ Sipas të dhënave të policisë, në vitin 2021, nga 5.312 raportime të dhunës në familje, 3.266 raste (61,5 për qind) u trajtuan me kërkesa për UM/UMM.^{22,23} Organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) që ofrojnë ndihmë juridike falas dhe shërbime të tjera mbështetëse për gratë viktime të dhunës në familje, identifikojnë disa arsye pse çështjet nuk arrijnë të procedohen në sistemin ligjor, ndër të cilat: pamundësia e dëshmitareve për të paraqitur prova, përfshirë një raport mjekësor²⁴; mungesa e raporteve të vlerësimit psikologjik²⁵; dhe mungesa e

18 Urdhra mbrojtjeje/Urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

19 Analizë e të dhënave, publikuar nga Policia e Shtetit Shqiptar.

20 Raporti Hije i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare dhe Rrjetit të Monitorimit dorëzuar në kuadër të ciklit të tretë të UPR për vlerësimin e Shqipërisë, 2019. Shih: http://www.qag-al.org/ang/publication/upr_shadow_report_eng.pdf

21 Të dhëna të analizuara mbi bazën e informacionit të publikuar nga Policia e Shtetit dhe të dhënat statistikore vjetore të Ministrisë së Drejtësisë. Shih: <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Vjetari-2020-i-plote-per-publikim-1.pdf>

22 Shih të dhënat e raportuara nga Policia e Shtetit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në kuadër të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore për vitin 2021, të dërguara me shkresën zyrtare me Nr.Prot.1720/1, datë 25.03.2022.

23 Në Vjetarin Statistikor për të njëjtin vit (2021), publikuar nga Ministria e Drejtësisë, raportohen 2.597 kërkesa të paraqitura në Gjykatë për urdhra mbrojtjeje, nga të cilat në 1.696 raste (65,3 për qind) u miratuan masat mbrojtëse me urdhër gjykate. Shih: Ministria e Drejtësisë, Vjetari Statistikor 2021 (fq.367), që gjendet në: <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/REPUBLIKA-E-SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B-Vjetari-Statistikor-2021-pdf.pdf>

24 Ndonëse gjykata duhet të kërkojë prova nga institucione të tjera (neni 15 i Ligjit për Dhunën në Familje), në praktikë kjo nuk ndodh dhe barra e provës i mbetet kryesisht viktimës; (këto janë procedura civile).

25 Sipas një raporti mbi monitorimin e vendimeve të gjykatave të rrethit gjyqësor të Tiranës në lidhje me masat mbrojtëse gjatë periudhës janar-qershor 2020, këto vlerësime u përgatitën vetëm në 11 për qind të rasteve.

ndihmës juridike për viktimat. Sipas një raporti të kohëve të fundit lidhur me monitorimin e veprimtarisë së gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2021, vetëm 41 për qind e viktimave të dhunës në familje u përfaqësuan me avokate/avokat gjatë procedurave gjyqësore për urdhra mbrojtjeje, nga të cilat 60 për qind e rasteve u përfaqësuan nga OSHC-të, 38 për qind nga avokate/avokatë private/privatë, dhe vetëm dy për qind nga avokate/avokatë të caktuar nga shteti në pajtim me ligjin për ndihmën juridike të vitit 2017.²⁶

- **Masat për ndjekjen penale të autorëve dhe lëshimin e Urdhërit për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM) zbatohen rrallë.** Në vitin 2021, nga 3.266 raste të trajtuara me kërkesa për UMM/UM, policia ka lëshuar UMPMM vetëm në 12,7 për qind (ose 415) të rasteve. Vetëm për gjysmën e tyre (52,6 për qind ose 237 raste), policia vendosi të largonte autorin e dhunës nga banesa e përbashkët.²⁷ Në vitin 2020, largimi i autorit të dhunës nga banesa e përbashkët u bë masë e detyrueshme për gjykatat. Që nga viti 2018, kjo masë parashikohet të zbatohet nga policia, bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut. Nëse niveli i rrezikut nga vlerësimi rezulton 'emergjent', atëherë policia duhet të nxjerrë UMPMM, në të cilin parashikon si masën e parë largimin e autorit të dhunës nga banesa e përbashkët. Përrjashtim bëhet vetëm në rastet kur autori i dhunës është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara. UMPMM i lëshuar nga policia është i vlefshëm derisa gjykata të lëshojë një UMM/UM. Megjithatë, lëshimi i UMPMM-ve nga policia shpesh anashkalohet, dhe në vend të kësaj, përgatiten vetëm kërkesat për UMM/UM, lëshimi i të cilave është nën përgjegjësinë e gjykatës. Pavarësisht nga kjo, gjykatat dhe policia tregojnë hezitim në zbatimin e kësaj mase, me arsyetimin se autorët e dhunës nuk kanë banesë tjetër ku të jetojnë.
- **Ka mungesë informacioni mbi zbatimin dhe monitorimin e masave mbrojtëse nga Policia dhe autoritetet e vetëqeverisjes vendore,** që kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë dhe të kryejnë monitorim të rregullt të masave mbrojtëse. Sipas legjislacionit, që nga viti 2018,

26 Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci (2021). Studim monitorues: Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Shih: <https://www.hrdc.al/index.php/al/sherbime/studime>

27 Qeveria e Shqipërisë (2023). Raport i Republikës së Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) - Raundi i parë i vlerësimit tematik: Krijimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/state-report-addressed-to-grevio-/1680ac0c69>

autoritetet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që, çdo 60 ditë, të dorëzojnë në polici raporte monitoruese të rregullta me shkrim për zbatimin e masave mbrojtëse, si dhe sa herë që konstatohet shkelje e urdhrimit të mbrojtjes. Kjo kërkon një bashkëpunim të fortë midis të gjithë anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) dhe një sistem monitorimi funksional të pajisur me metoda dhe mjete monitorimi. Formatet përkatëse të raportit të monitorimit dhe metodat e sugjeruara janë pjesë e Protokollit të miratuar zyrtarisht për menaxhimin e rasteve të DHF nga anëtarët e MKR. Megjithatë, deri më tani, monitorimi bëhet kryesisht me telefonata, dhe jo të gjitha bashkitë ndjekin praktikën e dorëzimit të raporteve të rregullta me shkrim.²⁸

- **Femicidi (vrasja e grave) nuk parandalohet në mënyrë të efektshme.** Gratë janë viktimat kryesore të vrasjeve në marrëdhëniet familjare. Në vitin 2021, nga 61 vrasje të personave, rreth 26,2 për qind ishin vrasje brenda marrëdhënieve familjare (neni 79/c i Kodit Penal), dhe 62,5 për qind e viktimave ishin gra.²⁹ Në vitin 2020, nga 52 vrasje të personave, rreth 13,5 për qind ishin vrasje brenda marrëdhënieve familjare (neni 79/c i Kodit Penal) dhe 88,9 për qind e viktimave ishin gra.³⁰ E shprehur në shifra, në vitin 2021, dhjetë gra u vranë nga bashkëshorti ose nga anëtarë të tjerë të familjes, gjashtë në vitin 2020, 12 në vitin 2019, dhe 11 në vitin 2018.³¹ Këto shifra nuk përfshijnë gratë e vrara nga jopartnerët apo persona që nuk janë anëtarë të familjes.
- **Niveli i hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të DHBGJ-së është i ulët.** Bazuar në informacionet e organizatave që punojnë në terren dhe në analizën e të dhënave të Prokurorisë së Përgjithshme, performanca në punën e prokurorive dhe të gjykatave për sa i përket hetimeve dhe ndjekjeve penale është përmirësuar.³² Megjithatë, numri i hetimeve të regjistruara ndërmjet rasteve të raportuara të dhunës në familje mbetet

28 Avokati i Popullit (2021). Raport mbi situatën e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020 – shtator 2021, dërguar Kuvendit të Shqipërisë në dhjetor 2021, fq.23. Shih: [https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20MONITORIM%20DHUNA%20JANAR%202020%20-%20SHTATOR%202022\[1164\].pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20MONITORIM%20DHUNA%20JANAR%202020%20-%20SHTATOR%202022[1164].pdf)

29 INSTAT (2022). Gra dhe burra në Shqipëri. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2022/burra-dhe-gra-2022/>

30 INSTAT (2021). Gra dhe burra në Shqipëri. Shih: <https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/publication/2022/women-and-men-in-albania-2021/>

31 *Po aty.*

32 Raporte vjetore të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të disponueshëm në: https://www.pp.gov.al/Dokumente/RAPORTE_T_PROKURORIT_T_P_RGJITHSH_M

shumë i ulët (38 për qind në vitin 2018, 28 për qind në vitin 2019, dhe 32 për qind në vitin 2020).³³

- **Mungesa e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore.** Pavarësisht nga përmirësimet e kohëve të fundit në sistemin e ndihmës juridike falas, viktimat e dhunës me bazë gjinore nuk kanë përfituar mjaftueshëm prej kësaj ndihme. Në vitin 2020, nga 4.100 raste gjithsej që përfituan ndihmë juridike parësore (pra këshillim ligjor), vetëm 157 ishin viktimat të dhunës në familje.³⁴ Në vitin 2021, nga 8.002 raste që përfituan ndihmë juridike parësore (5.644 përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe 2.059 në internet ose përmes telefonit), vetëm 259 ishin viktimat të dhunës në familje. Kjo do të thotë se, ndërkohë që numri i përgjithshëm i përfituesve/përfituesve pothuaj u dyfishua, viktimat e dhunës në familje nuk përfituan përpjesëtimisht me këtë rritje. Për sa i përket ndihmës juridike dytësore (pra përfaqësimit në gjykatë) dhe/ose përjashtimit nga shpenzimet gjyqësore, nga këto shërbime kanë përfituar 65 viktimat të dhunës në familje.³⁵ Përgjithësisht, këto shifra mbeten shumë të ulëta krahasuar me numrin faktik të rasteve të raportuara të dhunës apo me numrin e përgjithshëm të përfituesve/përfituesve të ndihmës juridike falas. Në ato raste kur jepet ndihmë juridike falas, ajo ofrohet kryesisht për urdhra mbrojtës në kuadër të procedurave civile dhe jo në procedura penale, megjithëse viktimat e dhunës në familje kanë të drejtën për të pasur avokate/avokat në përputhje me legjislacionin penal dhe me ligjin për ndihmën juridike falas. Përjashtimi nga pagimi i shpenzimeve dhe rimbursimi i shpenzimeve të gjykatës dhe i shpenzimeve për ekspertet/ ekspertët mbetet shumë i vështirë.³⁶ OSHC-të raportojnë se ato viktimat që nuk kanë akses në ndihmë juridike falas, kanë më shumë gjasa ta

33 Bazuar në llogaritjet e të dhënave të ofruara nga plani i veprimit i qeverisë shqiptare për zbatimin e një vendimi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për një çështje të dhunës në familje (Tërshana, Shqipëri). Shih: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%E2%2BTërshana%22%7D%22EXECIdentifier%22:%E2%2DDH-DD\(2021\)746E%22%7D](https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%E2%2BTërshana%22%7D%22EXECIdentifier%22:%E2%2DDH-DD(2021)746E%22%7D)

34 Raport vjetor i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, 2020. Gjetet në: <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/RAPORT-VJETOR-MBI-VEPRIMTARINË-E-DNJF-RIPUNUAR...pdf>

35 Të dhëna nga Raporti i Avokati i Popullit (2021). Raport mbi situatën e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën janar 2020 – shtator 2021, dërguar Kuvendit të Shqipërisë në dhjetor 2021. Shih: [https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20MONITORIM%20DHUNA%20JANAR%202020%20-%20SHTATOR%202022\[1164\].pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORT%20MONITORIM%20DHUNA%20JANAR%202020%20-%20SHTATOR%202022[1164].pdf)

36 Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2020), *Common Country Analysis* (Analizë e përbashkët për vendin); UN Women, Shqipëri (2020), *Country Gender Equality Brief Albania* (Dosja e Barazisë Gjinore e Shqipërisë).

tërheqin padinë e tyre, nuk e kuptojnë rëndësinë e urdhrave mbrojtës, e kanë të vështirë të mbledhin prova, ose u janë nënshtruar praktikave të dëmshme të pajtimit gjyqësor. Tërheqja e padisë për këto arsye ishte veçanërisht e zakonshme deri në ndryshimin e Ligjit për Dhunën në Familje në vitin 2018.³⁷

Martestat e hershme dhe të fëmijëve vazhdojnë të ekzistojnë. Monitorimi i urdhrave gjyqësorë tregon se gjykatat mund të lejojnë martesat përpara arritjes së moshës minimale për martesë, sipas rastit, për arsye të shtatzënisë, lindjes së fëmijës, apo bashkëjetesës, dhe se shpeshherë vendimet e marra nga gjykatat në këto raste nuk janë në interesin më të lartë të fëmijëve në fjalë.³⁸ Pjesa më e madhe e fëmijëve të martuar nën moshë janë vajza. Në vitin 2020, numri i vajzave të martuara përpara moshës 18 vjeçare ishte 16. Kjo shënoi rënie në krahasim me vitin 2019, kur pati 20 martesat e personave të mitur. Në vitin 2020, numri i vajzave të martuara në moshën 18 vjeçare përbënte 6,6 për qind, dhe numri i vajzave të martuara në moshën 19 vjeçare përbënte 5,5 për qind të numrit të përgjithshëm të martesave. Megjithatë, në vitin 2021 situata ndryshoi sërish dhe numri i vajzave të martuara përpara moshës 18 vjeçare ishte 19, që paraqet një rritje krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2021, numri i vajzave të martuara në moshën 18 vjeçare përbënte 6,4 për qind dhe numri i vajzave të martuara në moshën 19 vjeçare përbënte 5,8 për qind të numrit të përgjithshëm të martesave. Nga ana tjetër, nuk ka martesat e regjistruara të djemve para moshës 18 vjeçare, ndërsa proporcioni i djemve të martuar në moshën 18 -19 vjeçare është nën një për qind, si për vitin 2020 ashtu edhe për vitin 2021.^{39,40} Në këto shifra nuk përfshihen martesat e paregjistruara; faktikisht shkalla e përhapjes së këtyre martesave është më e lartë. Numri i martesave të fëmijëve është më i madh në zonat rurale dhe ato të thella, si dhe në komunitetet rome; megjithatë, nuk janë të disponueshme statistika të sakta në lidhje me to. Ekspertet/ekspertët e barazisë gjinore dhe për çështjet e të drejtave familjare dhe të fëmijëve raportojnë gjithashtu se gjykatat nuk i zbatojnë në mënyrë konsistente garancitë procedurale që synojnë kufizimin e

37 Raport i palëve për Rishikimin Periodik Universal të Kombeve të Bashkuara, paraqitur nga Avokatët për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci, 2019.

38 UNICEF (2021). *Situation analysis of Children and Adolescents in Albania*. (Analiza e situatës së fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri). Shih: <https://www.unicef.org/albania/documents/situation-analysis-children-and-adolescents-albania>

39 INSTAT (2021). Gra dhe burra në Shqipëri. Shih: <https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/publication/2022/women-and-men-in-albania-2021/>

40 INSTAT (2022). Gra dhe burra në Shqipëri. Shih: <https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2022/men-and-women-2022/>

miratimeve të rasteve përjashtimore të martesave të fëmijëve nën moshën 18 vjeç. Mungojnë të dhënat administrative mbi urdhrat e gjykatave në lidhje me martesat e fëmijëve.

Numri i rasteve të vendimeve të fajësisë të formës së prerë për trafikantët e grave dhe fëmijëve mbetet shumë i ulët. Ndonëse Shqipëria ka bërë përparim në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ajo vazhdon të vuajë nga kjo e keqe e madhe shoqërore dhe ka shenja të rritjes së trafikimit të brendshëm të grave dhe fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe lypjes, përfshirë shfrytëzimin seksual në hotele ose shtëpi publike, si edhe në zona turistike.⁴¹ Në vitin 2020, u identifikuan dhe ndihmuan 86 viktima, krahasuar me 92 viktima në vitin 2019. Në vitin 2020, Prokuroria regjistroi 28 procedime të reja penale për trafikim të qenieve njerëzore, krahasuar me 25 procedime në vitin 2019. Numri i vendimeve të fajësisë të formës së prerë vazhdoi të ishte shumë i ulët, me vetëm dy çështje gjyqësore në të cilat u dhanë tre vendime fajësie të formës së prerë në vitin 2020, dhe tri çështje gjyqësore me pesë vendime fajësie në vitin 2019.⁴² Shqipëria vazhdon të jetë vend i nivelit të dytë në klasifikimin e Departamentit të Shtetit të SHBA-së, në raportin vjetor të të cilit nënvizohet mungesa e përvojës së specializuar dhe e kapaciteteve të prokurorisë për ndjekjen e suksesshme penale të rasteve të trafikimit, si edhe burimet e pamjaftueshme dhe ndryshimi i vazhdueshëm i personelit në organet ligjzbatuese.⁴³

41 Informacioni i dhënë nga IOM për Ekipin e Kombeve të Bashkuara për Vendin në lidhje me Raportin Alternativ të Zbatimit të CEDAW, shkurt 2022.

42 Komisioni Evropian (2021). Raporti për Shqipërinë për vitin 2021, me të dhënat më të fundit të disponueshme nga viti 2020.

43 Departamenti i Shtetit të SHBA (2021). *Trafficking in Persons Report*. (Raport mbi trafikimin e qenieve njerëzore). Shih: <https://www.state.gov/reports/2021-trafficking-in-persons-report/>

KUTIA 1

Treguesit kryesorë të fushës përkatëse të politikave të BE-së për të cilat ka të dhëna të disponueshme në Shqipëri

- Numri i veprimeve legjislative të ndërmarra në shtetin partner për penalizimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën përmes internetit, si dhe për ndjekjen penale të autorëve të dhunës, në përputhje me standardet ndërkombëtare
- Numri i veprimeve legjislative të ndërmarra në shtetin partner për të siguruar që të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore u mundësohet të kenë akses në drejtësi
- Proporcioni i grave të moshës 20-24 vjeç që ishin të martuara ose bashkëjetonin përpara moshës 15 vjeç dhe përpara moshës 18 vjeç
- Numri i rasteve të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore (DHSBGJ) që raportohen në polici, sipas viteve, të ndara të paktën sipas seksit
- % e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të trafikimit që u intervistuan në një dhomë vizitash të sigurt dhe private, e ndarë të paktën sipas seksit

Burimi: Komisioni Evropian, (2020). *Objectives and Indicators to frame the implementation of the EU Gender Action Plan III (2021-25)*. [Objektiva dhe tregues për strukturimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së (2021-25)]. I disponueshëm në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/14a6e4fa-2f21-11eb-b27b-01aa75ed71a1/language-en>

Pavarësisht nga përmirësimet në legjislacionin kundër diskriminimit, në praktikë gratë nuk përfitojnë nga mjetet ligjore.⁴⁴ Përgjithësisht, jurisprudenca e Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD) në fushën e luftës kundër diskriminimit ende nuk është zhvilluar në nivel të konsiderueshëm.⁴⁵ Në vitin 2020, nga 175 ankesa⁴⁶ të paraqitura nga individë dhe të trajtuara në KMD (nga të cilat 63 ankesa, ose 36 për qind e ankesave,

44 CEDAW (2016). *Concluding Observations on the 4th periodic report of Albania, 2016, paragraphs 10 and 11*. (Vërejtjet përmbyllëse mbi raportin e 4-rt periodik të Shqipërisë, 2016, paragrafët 10 dhe 11). I disponueshëm në: <https://digitallibrary.un.org/record/840818?ln=en>

45 Komisioni Evropian (2021). *Albania 2021 Report*. (Raporti për Shqipërinë 2021). I disponueshëm në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en

46 Nga të cilat 134 ankesa nga individë janë regjistruar në vitin 2020 dhe 41 ankesa nga individë janë të mbartura nga viti 2019.

ishin nga gra), në 13 prej tyre 'gjinia' figuronte si arsyeja bazë e diskriminimit; nga këto, shtatë raste u shqyrtuan nga KMD-ja dhe në një rast u dha vendim. Në vitin 2021, nga 261 ankesa që iu paraqitën KMD-së nga individë⁴⁷, (nga të cilat 53 ankesa, ose 20,3 për qind e ankesave, ishin nga gra), 30 ishin për diskriminim gjinor; nga këto 15 raste u shqyrtuan nga KMD-ja dhe u dhanë tre vendime që konfirmonin se kishte pasur praktikë diskriminuese. Në vitin 2022, nga 221 ankesa që iu paraqitën KMD-së nga individë⁴⁸, (nga të cilat 93 ankesa, ose 42 për qind e ankesave, ishin nga gra), 16 ishin për diskriminim gjinor; nga këto shtatë raste u shqyrtuan nga KMD-ja dhe u dhanë dy vendime që konfirmonin se kishte pasur praktikë diskriminuese. Shumica e këtyre ankesave lidheshin me diskriminimin në vendin e punës.⁴⁹ Deri më tani nuk ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore në jurisprudencën e mosdiskriminimit, dhe ka mungesë interpretimi nga gjykatat të parimit të mbrojtjes nga diskriminimi, përfshirë edhe nga diskriminimi për shkak të gjinisë.⁵⁰ Në përgjithësi, procesi i rishikimit është i ngadaltë, siç ilustron nga numri i konsiderueshëm i ankesave të mbartura nga vitet e mëparshme.

Në shkurt 2022, Shqipëria ratifikoi Konventën nr. 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimeve në Botën e Punës (2019), por **të dhënat mbi përhapjen e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës mungojnë.**

47 Nga të cilat 214 ankesa nga individë janë regjistruar në vitin 2021 dhe 47 ankesa nga individë janë të mbartura nga viti 2020.

48 Nga të cilat 157 ankesa nga individë janë regjistruar në vitin 2022 dhe 64 ankesa nga individë janë të mbartura nga viti 2021.

49 Raporte të përvitshme të Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi për vitin 2020, 2021 dhe 2022. Të disponueshme në: <https://www.kmd.al/raporte-vjetore/>

50 Raport vlerësimi 'Vendime të gjykatave mbi parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit', përgatitur nga KMD-ja me mbështetjen e PNUD-it, 2021. I disponueshëm në: https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2022-08/ENGLISH_UNDP%20Print_The%20Principle%20of%20Equality%20and%20Non-Discrimination%20Analysis%20of%20Case%20Law%202013-2020.pdf

KUTIA 2

Treguesit specifike kryesore të BE-së mbi aksesin në drejtësi

- Nëse është krijuar ose jo kuadri ligjor për promovimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e barazisë dhe mosdiskriminimit me bazë seksin
- Shkalla në të cilën rishikohet legjislacioni për të hequr klauzolat diskriminuese gjinore në lidhje me familjen, zgjidhjen e martesës, kujdestarinë e fëmijëve, trashëgiminë, punësimin, pagën, sigurimet shoqërore, zotërimin e pronave dhe të tokës, etj.
- % e popullsisë që e percepton cilësinë e përgjithshme të drejtësisë së ofruar si të mirë ose shumë të mirë, ndarë më së paku sipas seksit
- Proporcioni i popullsisë që raporton se është ndjerë personalisht e/i diskriminuar ose e/i ngacmuar në 12 muajt e fundit, për një arsye diskriminimi që ndalohet në bazë të të drejtave ndërkombëtare të njeriut
- Numri i konsultimeve të autoriteteve qeveritare partnere në nivel kombëtar dhe vendor me organizatat e të drejtave të grave të angazhuara në fushën e avokatisë për reforma në drejtësi

Burimi: Komisioni Evropian, (2020). *Objectives and Indicators to frame the implementation of the EU Gender Action Plan III (2021-25)*. [Objektiva dhe tregues për strukturimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së (2021-25)]. I disponueshëm në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/14a6e4fa-2f21-11eb-b27b-01aa75ed71a1/language-en>

Vendimet e gjykatave në favor të grave në çështje gjyqësore familjare, të pronës, apo çështje të tjera ligjore nuk ekzekutohen rregullisht. Ky aspekt theksohet nga Komiteti CEDAW si një problem i përhapur dhe një nga çështjet më shqetësuese që lidhen me aksesin e grave në drejtësi.⁵¹ Të dhëna administrative për periudhën 2016-2020 tregojnë se përqindja e vendimeve gjyqësore të paekzekutuara që lidhen me pagesën e detyrimit ushqimor varion nga 25 deri në 40 për qind, me një tendencë në rritje në përpjesëtim të drejtë me rritjen e numrit të këtyre vendimeve nga gjykatat. Kundër prindit debitor, pra baballarëve, janë paraqitur vetëm një numër i kufizuar padish penale. Çështjet e përmbarimit që kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave lidhur me fëmijët prekin veçanërisht gratë, sepse në shumicën e rasteve fëmijët

⁵¹ CEDAW (2016). *Concluding Observations on the 4th periodic report of Albania, 2016*. (Vërejtjet përmbyllëse mbi raportin e katërt periodik të Shqipërisë, 2016). I disponueshëm në: <https://digitallibrary.un.org/record/840818?ln=en>

u lihen nënave për rritje dhe edukim. Kjo çështje është ngritur gjithashtu edhe në shumë raporte të zyrës së Avokatit të Popullit, ku është shprehur shqetësimi për njohuritë e pjesshme të përmbarduesve për legjislacionin civil dhe procedural në fuqi, çka ndikon negativisht në respektimin e të drejtave procedurale të qytetarëve/ qytetarëve.⁵²

Sistemi i ndihmës juridike falas nuk u shërben mjaftueshëm grave nga grupet e pafavorizuara. Në bazë të ligjit mbi ndihmën juridike falas të vitit 2017, ndihma juridike, që përfshin këshillimin ligjor (ndihma juridike parësore), përfaqësimin në gjykatë (ndihma juridike dytësore) dhe përjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore dhe shpenzimeve për ekspertet/ekspertët, duhet përfitohet nga: a) personat që janë në gjendje të vështirë financiare, të cilët duhet të vërtetojnë statusin e tyre; dhe b) personat që u përkasin kategorive të veçanta (për shembull, personat me aftësi të kufizuara; viktimat e dhunës në familje, trafikimit ose abuzimit seksual; fëmijët; personat që përfitojnë ndihmë ekonomike; dhe të tjerë), të cilët e përfitojnë automatikisht mbi bazën e statusit të tyre.

Megjithatë, numri i grave që kanë nevojë për ndihmë juridike falas dhe që janë në gjendje të vështirë financiare ose që përfshihen në këto kategori të ligjit është shumë më i lartë se sa numri i grave që faktikisht e përfitojnë këtë ndihmë. Nga 5.644 që ishte numri i përgjithshëm i përfituesve/ përfituesve të ndihmës juridike parësore në vitin 2021 – që është një shifër relativisht e ulët duke pasur parasysh gamën e gjerë të kategorive që parashikon ligji – 3.263 ishin gra dhe 2.381 burra.⁵³ Në vitin 2020, 2.584 persona përfituan nga shërbimet e ndihmës juridike falas përmes takimeve ballë për ballë dhe 1.760 përmes internetit; por për këtë vit nuk ekzistojnë të dhëna të ndara sipas seksit.⁵⁴ Nuk ka informacion të disponueshëm lidhur me llojin e çështjeve

52 Avokati i Popullit (2020). *Alternative report on the implementation of the CEDAW Convention in Albania 2016-2020. Prepared by the Ombudsperson of the Republic of Albania for the presentation before the United Nations Committee on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women (CEDAW)*. [Raport alternativ mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri 2016 – 2020. Përgatitur nga Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë për t'u prezantuar përpara Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)]. I disponueshëm në: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/alternative-report-on-the-implementation-of-the-cedaw-convention-in-albania>

53 Këto të dhëna nuk përfshijnë personat që përfitojnë ndihmë juridike falas përmes platformave në internet dhe telefonit, për shkak të pamundësisë së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (DNJF) për t'i ndarë këto të dhëna sipas seksit.

54 Shih raportet e DNJF-së për vitet 2021 dhe 2020: <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti-vjetor-per-vitin-2021-converted.pdf> dhe https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2021/01/RAPORT-VJETOR-MBI-VEPRIMTARINË-E-DNJF_RIPUNUAR...pdf

gjyqësore në të cilat janë përfaqësuar gratë dhe nëse ato u përkisnin grupeve të marginalizuara (për shembull, gra rome dhe egjiptiane, gra me aftësi të kufizuara, gra nga zonat rurale, etj.).

Në veçanti, ndihma juridike dytësore (pra përfaqësimi në gjykatë dhe/ose përjashtimi nga shpenzimet e gjykatës dhe pagesat për ekspertet/ekspertët), që është një prej aspekteve më të rëndësishme të aksesit në drejtësi, i ofrohet një numri shumë të kufizuar të grave. Në vitin 2021, nga 849 kërkesa gjithsej, 671 persona përfituan ndihmë juridike dytësore. Pjesa më e madhe e kërkesave (70 për qind) bazoheshin në arsye financiare dhe 30 për qind ishin nga kategoritë e veçanta që kanë të drejtën të përfitojnë ndihmë juridike falas pavarësisht nga statusi financiar.⁵⁵ Në vitin 2020, gjykatat lëshuan 157 urdhra për miratimin e ndihmës juridike falas, pjesa më e madhe e të cilëve ishin për përfaqësim ligjor, ndërsa një numër më i vogël për përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve të gjykatës dhe për ekspertet/ekspertët.⁵⁶ Me gjithë nevojën evidente për ndihmë juridike falas për gratë, fondi përkatës i alokuar nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2022 ishte pak më i ulët se në vitin 2021.

Megjithëse klinikat ligjore që ofrojnë ndihmë juridike falas administrohen nga Ministria e Drejtësisë, ofrimi i këtij shërbimi dhe funksionimi i përditshëm vazhdojnë të mbështeten nga organizatat dhe partnerët ndërkombëtarë.⁵⁷ OSHC-të e autorizuar për të ofruar ndihmë ligjore falas kanë të drejtë të marrin fonde qeveritare mbi bazën e konkurrimit; megjithatë, për shkak të mungesës së procedurave të qarta, në vitet 2020 dhe 2021 ky modalitet nuk u përdor. Pjesa më e madhe e OSHC-ve të autorizuar janë të specializuara për ofrimin e ndihmës juridike për gratë viktime të dhunës me bazë gjinore, gratë dhe komunitetet e pafavorizuara, fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe ato kanë përvojën dhe ekspertizën profesionale ligjore për ofrimin e kësaj ndihme.⁵⁸

55 Këto kategori përfshijnë viktimat e dhunës në familje, të abuzimit seksual, të trafikimit të qenieve njerëzore, personat me aftësi të kufizuara, të miturat/miturit që kanë kryer vepra penale, fëmijët në institucione të kujdesit social, personat të cilëve u janë shkelur të drejtat nga veprime apo mosveprime që kanë çuar në diskriminim, etj.

56 Raporti vjetor i DNJF-së nuk përfshin të dhëna të ndara sipas seksit, megjithëse ky informacion është i disponueshëm në raportet mujore të publikuara në faqen e internetit të DNJF-së.

57 Për shembull, UNDP dhe Agjencia Austriake për Zhvillim.

58 Shih: <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/REGJISTRI-I-ORGANIZATAVE-JOFITIMPRURERE-QE-OFROJNE-NDIHME-JURIDIKE-PARESORE.pdf>

Me propozimin e kohëve të fundit për reformimin dhe shpërndarjen e re territoriale të gjykatave të shkallës së parë dhe pakësimin e numrit të tyre nga 22 në 12, aksesit i grave në drejtësi mund të përballet me sfida të reja.⁵⁹ Ky riorganizim mund t'ua vështirësojë grave ndjekjen e seancave gjyqësore në rrethe që janë larg nga vendbanimi i tyre; sidomos e vështirë do të jetë kjo për gratë që nuk kanë makinë ose nuk e ngasin makinën, si dhe për gratë që jetojnë në zona rurale, e veçanërisht ato në zona të thella rurale.

Të drejtat pronësore të grave pengohen nga niveli i ulët i regjistrimit të tyre si bashkëpronare. Në legjislacionin që u garanton grave të drejta të barabarta pronësore dhe të trashëgimisë janë bërë përmirësime të konsiderueshme.⁶⁰ Megjithatë, shumë gra nuk janë të regjistruara si pronare të shtëpive, tokave dhe pasurive të tjera, të cilat në pjesën më të madhe vazhdojnë të jenë të regjistruara në emër të bashkëshortëve ose anëtarëve të tjerë burra të familjes. Si rezultat, gratë nuk mund të përfitojnë plotësisht nga pasuritë që kanë, përfshirë edhe për marrjen e huave apo të kredive, dhe ato rrezikojnë të humbin të drejtat e tyre mbi pronën në rast të zgjidhjes së martesës, ose u duhet t'i kërkojnë të drejtat e tyre përmes zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në gjykatë. Të dhënat për gratë pronare janë të vjetruara dhe gjatë viteve janë karakterizuar nga mungesa e një metodologjie të qëndrueshme lidhur me ndarjen e tyre sipas seksit.

Mangësitë në të dhënat gjinore në fushën e drejtësisë pengojnë trajtimin e pabarazive dhe të sfidave që lidhen me gjininë. Të dhënat e ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore janë thelbësore për të kuptuar situatën e grave dhe burrave në fushën e drejtësisë. Ato janë gjithashtu thelbësore për kryerjen e analizave gjinore, zhvillimin e politikave të përgjigjshme gjinore dhe marrjen e masave që trajtojnë pabarazitë dhe sfidat që lidhen me gjininë. Në parim, është e mundur të llogariten disa tregues kryesorë të BE-së mbi gjininë dhe drejtësinë në Shqipëri, mbi bazën e të dhënave administrative ekzistuese.

59 Shih: <http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/12/NJË-HARTË-E-RE-GJYQËSORE-.pdf>

60 Me miratimin e ligjit të ri për kadastrën, si dhe të ligjit mbi noterinë në vitin 2018.

KUTIA 3

Treguesit kryesorë të BE-së për fushën përkatëse të politikave, që është e mundshme të llogariten në Shqipëri

(Treguesit në këtë listë janë pjesë e treguesve tematikë të ndikimit në kuadër të OZHQ 5 dhe OZHQ16, dhe iu referohen konkretisht Synimeve të: OZHQ 5.2.13, OZHQ 5.2.23, OZHQ 5.3.2, dhe OZHQ 16.2.2)

- % e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale ndaj grave dhe fëmijëve që janë hetuar dhe për të cilat janë dhënë dënime
- % e grave dhe vajzave që raportojnë se ndihen më të sigurta dhe/ose kanë më shumë siguri në hapësirat private dhe publike (përfshirë dhe lëvizjen në to)
- % e grave, përfshirë ato që përballen me forma të ndërthurura dhe të shumëfishta të diskriminimit, që raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale, të cilat kërkojnë ndihmë, sipas sektorit, domethënë (a) shërbime nga institucionet shtetërore dhe shërbimet nga shoqëria civile; ose (b) shërbime të mirëqenies sociale, ndihma juridike falas, strehimi, mbrojtja nga policia
- % e rasteve të dhunës me bazë gjinore që janë raportuar në polici dhe janë dërguar në gjykatë, që kanë rezultuar në dënimin e autorëve të dhunës, ndarë së paku sipas seksit
- Numri i rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale që raportohen në polici çdo vit, ndarë së paku sipas seksit
- % e rasteve të dhunës me bazë gjinore që raportohen në polici çdo vit, ndarë së paku sipas seksit
- % e rasteve të dhunës me bazë gjinore që raportohen në polici dhe që dërgohen në gjykatë çdo vit, ndarë së paku sipas seksit
- % e viktimave/të mbijetuarave/të mbijetuarve të trafikimit që janë intervistuar në një dhomë vizitash të sigurt, private, ndarë së paku sipas seksit
- Proporcioni i popullsisë që raporton se është ndjerë personalisht e/i diskriminuar ose e/i ngacmuar në 12 muajt e fundit, për një arsye diskriminimi që ndalohet në bazë të të drejtave ndërkombëtare të njeriut

Burimi: Komisioni Evropian (2020). *Objectives and Indicators to frame the implementation of the EU Gender Action Plan III (2021-25)*. [Objektiva dhe tregues për strukturimin e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së (2021-25)]. I disponueshëm në: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/14a6e4fa-2f21-11eb-b27b-01aa75ed71a1/language-en>

Parakusht për përcaktimin e këtyre treguesve është bashkërendimi më i mirë ndërmjet institucioneve. Të dhënat që kërkohen për të bërë llogaritjet mund të merren nga vërtetimet e INSTAT-it për dhunën me bazë gjinore, raportet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Zyra e Përmbartimit, Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe institucione të tjera të drejtësisë.⁶¹

KUTIA 4

Përmbledhje e problemeve kryesore të pabarazisë gjinore në sektorin e drejtësisë në Shqipëri

- Përhapja e madhe e dhunës me bazë gjinore;
- Martesat e fëmijëve vazhdojnë të ekzistojnë dhe madje vazhdojnë të tolerohen nga disa gjykata;
- Numri i vogël i hetimeve dhe ndjekjeve penale për autorët e trafikimit të grave dhe fëmijëve;
- Mekanizmat kundër diskriminimit dhe gjykatat nuk zbatojnë me efektivitet legjislativ kundër diskriminimit për sa i përket barazisë gjinore dhe formave të tjera të ndërthurura të diskriminimit të shumëfishtë;
- Vendimet e gjykatave në favor të grave në çështje gjyqësore familjare, pronësore, apo çështje të tjera ligjore nuk ekzekutohen në mënyrë të vazhdueshme;
- Gratë e marginalizuara nuk përfitojnë nga sistemi i ndihmës juridike falas, veçanërisht nga ndihma ligjore dytësore;
- Shumë gra vazhdojnë të mos jenë të regjistruara si pronare të pronave të tyre;
- Mangësitë në statistika gjinore në drejtësi.

⁶¹ Dokumenti i metadatave për treguesit e lidhur me OZHQ-të rekomandon përdorimin e burimeve kombëtare të të dhënave, ku një prej tyre është Vërtetimi Kombëtar mbi Dhunën me Bazë Gjinore që kryen INSTAT-i.

2 BARAZIA GJINORE DHE DREJTËSIA NË KONTEKSTIN E ANËTARËSIMIT NË BE

Drejtësia është një sektor që kryesisht përfshihet në përgjegjësinë e secilit prej shteteve anëtare të BE-së, që – në pajtim me legjislacionin e tyre kombëtar, legjislacionin e BE-së dhe standarde të tjera ndërkombëtare – duhet të sigurojnë akses në drejtësi për të gjithë personat në juridiksionet e tyre. Në të njëjtën kohë, sektori i drejtësisë mbetet element thelbësor në kuadër të legjislacionit të BE-së, ku përfshihet Karta Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore, e cila përmbledh në një tekst të vetëm të gjitha të drejtat individuale, civile, politike, ekonomike dhe sociale që gëzojnë personat në vendet e BE-së. Një numër nenesh të Kartës Evropiane garantojnë akses të barabartë në drejtësi për të gjitha/gjithë.

Sistemi i BE-së ka krijuar një numër mekanizmesh të parashikuara në Traktatin mbi Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE), të cilët u mundësojnë qytetareve/qytetarëve të shteteve anëtare të BE-së të kërkojnë angazhimin e institucioneve të BE-së kur hasin vështirësi për të pasur akses në drejtësi në vendin e tyre. Përveç kësaj, institucionet e BE-së mund të veprojnë edhe me nismën e tyre, bazuar në kompetencat e përbashkëta të Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, parashikuar në nenin 4(2)(j) të TFBE-së.⁶² Mbi këtë bazë, BE-ja ka miratuar disa instrumente për përmirësimin e aksesit në drejtësi për qytetaret/qytetarët, me një ndikim veçanërisht pozitiv për gratë, ndër të cilat:

- Direktiva 2002/8/EC mbi rregullat minimale të përbashkëta lidhur me ndihmën juridike falas;⁶³
- Direktiva 2012/29/EU mbi të drejtat e viktimave;⁶⁴
- Direktiva 2012/13/ EU mbi të drejtën për informacion në procedura ligjore;⁶⁵
- Direktiva 2013/48/EU mbi të drejtën për të pasur akses në një avokat;⁶⁶
- Direktiva 2016/34 mbi prezumimin e pafajësisë.⁶⁷

62 Parlamenti Evropian (2017). *Effective Access to Justice*. (Aksesi efektiv në drejtësi). Studim i porositur nga Departamenti për të Drejtat e Qytetarëve dhe Çështje Kushtetuese i Parlamentit Evropian me kërkesë të Komisionit të Peticioneve të Parlamentit Evropian (PETI). Shih: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/596818/IPOL_STU\(2017\)596818_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2017/596818/IPOL_STU(2017)596818_EN.pdf)

63 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:32003L0008>

64 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32012L0029>

65 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32012L0013>

66 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32013L0048>

67 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32016L0343>

Institucionet e BE-së gjithashtu zbatojnë programe dhe nisma për promovimin e shtetit të së drejtës dhe të aksesit në drejtësi, ndër të cilët Korniza Vlerësuese e BE-së për Drejtësinë⁶⁸ dhe disa instrumente të tjera për përmirësimin e efektivitetit të sistemeve kombëtare të drejtësisë.⁶⁹

Në lidhje me barazinë gjinore në sistemin e drejtësisë, politika e BE-së fokusohet kryesisht në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe sigurimin e mbrojtjes për gratë viktime të krimit. Gjatë viteve të fundit, Komisioni Evropian ka marrë disa masa legjislative dhe jolegjislative për të siguruar mbrojtjen e grave viktime të krimit, në veçanti të dhunës, dhe për të luftuar dhunën me bazë gjinore.

Konsideratat e barazisë gjinore luajnë një rol kryesor në përcaktimin e drejtimeve strategjike në sektorin e drejtësisë në BE. Ato përcaktojnë si politikat e brendshme, ashtu edhe veprimin e jashtëm të BE-së. Në fushën e politikave të drejtësisë, rëndësia e barazisë gjinore shihet në lidhje me këto pika:

- **Aksesi në drejtësi është e drejtë njerëzore dhe aspekt integral i shtetit të së drejtës.** Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore në fushën e aksesit në drejtësi është veçanërisht i rëndësishëm në kuadër të pasojave të krizës ekonomike, sepse pabarazitë në të gjitha nivelet e shoqërisë kanë qenë në rritje dhe kanë ndikuar negativisht në jetën e grave.⁷⁰ Gjithashtu, me gjithë numrin e madh të ligjeve ndërkombëtare që garantojnë të drejta të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, aksesit i grave në drejtësi nuk është i barabartë. Kjo vjen si pasojë e ndërthurjes së pabarazive në nivel ligjor, institucional, strukturor, social-ekonomik dhe kulturor. Për këtë arsye, garantimi i aksesit të barabartë të grave në drejtësi nënkupton që ato të kenë akses në mjete ligjore të drejta, të përballeshme financiarisht, llogaridhënese dhe efektive, në mënyrë

68 Korniza Vlerësuese e BE-së për drejtësinë paraqet një pasqyrë të përvitshme të treguesve të efikasitetit, cilësisë dhe pavarësisë së sistemeve të drejtësisë. Qëllimi i saj është që t'u vijë në ndihmë shteteve anëtare të përmirësojnë efektivitetin e sistemeve të drejtësisë përmes ofrimit të të dhënave objektive, të mbështetshme dhe të krahasueshme.

69 Semestri Evropian, Fondet strukturore në mbështetje të reformave në drejtësi, mbështetja teknike për reformat në drejtësi, Mekanizmi i Bashkëpunimit dhe Verifikimit. Portali evropian i drejtësisë e-Justice. Shih: https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/upholding-rule-law/improving-effectiveness-national-justice-systems_en

70 UN Women (2020). *The impact of Covid-19 on women's and men's lives and livelihoods in Europe dhe Central Asia: Preliminary results from a rapid gender assessment*. (Ndikimi i Covid-19 në jetën dhe të ardhurat e grave dhe të burrave në Evropë dhe Azinë Qendrore: Rezultate paraprake nga një vlerësim gjinor i shpejtë). Shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods>

që gratë dhe burrat të gëzojnë të drejta të barabarta dhe t'u ofrohen mundësi të barabarta për ushtrimin e këtyre të drejtave.⁷¹

- **Krimi është një dukuri me orientim gjinor, por sistemi i drejtësisë nuk u përgjigjet nevojave të grave dhe të burrave në mënyrë të barabartë.** Krimi nuk është dukuri gjinore asnjëse. Studime të ndryshme kanë treguar se, në përgjithësi, gratë dhe burrat kryejnë lloje të ndryshme veprash penale. Për shembull, kur gratë shkelin ligjin, ato kryejnë më tepër veprat penale të vjedhjes dhe grabitjes së pronës dhe përfshihen më pak në dhunë të rëndë, dëm kriminal dhe krim profesional. Megjithatë, konceptet dhe parimet e përgjithshme të ligjit janë më shumë përfaqësuese të përvojave të burrave se sa të grave.⁷²
- **Njohja e aspektit gjinor të krimit nuk është vetëm një çështje që ka të bëjë me barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, por edhe çështje ekonomike.** Kostoja e dhunës nga partneri intim në BE shkon në 122 miliard euro; nga kjo shifër, dhuna e partnerit intim ndaj grave përfaqëson një kosto prej 109 miliard euro, që përbën 89 për qind të koston së përgjithshme. Kostoja e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore kundër grave në BE shkon në 225 miliard euro. Kjo përfaqëson 87 për qind të koston së përgjithshme të dhunës me bazë gjinore në BE.⁷³

⁷¹ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (2022). *Relevance of gender in the justice area*. (Rëndësia e gjinisë në fushën e drejtësisë). Shih: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/policy-areas/justice>

⁷² *Po aty*.

⁷³ *Po aty*.

TABELA 1

Shembuj të mangësive gjinore në sistemin e drejtësisë

E drejta penale	E drejta civile
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gratë mund të jenë viktime të krimeve jashtëzakonisht traumatike, nga të cilat dhuna me bazë gjinore në të gjitha format e saj është aspekti më i dukshëm, me pasoja si fizike ashtu edhe psikologjike. ▪ Praktikrat gjyqësore dhe kërkesat procedurale ekzistuese nuk i favorizojnë sa duhet viktimat; shumë shpesh ato nuk arrijnë të shmangin viktimizimin dytësor dhe tjetërsimin e viktimave nga procesi, duke bërë që ato ta tërheqin padinë. ▪ Viktimizimi dytësor duhet të shmanget jo vetëm përmes procedurave gjyqësore të zbatuara, por edhe nga personeli policor dhe personeli i sistemit të drejtësisë. Viktimizimi dytësor është mjaft i zakonshëm, për shembull, në rastin e grave viktime të dhunës në familje ose punonjëseve të seksit që përjetojnë dhunë seksuale ose dhunë në familje.⁷⁴ 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E drejta familjare dhe sistemi i së drejtës civile trajtojnë një varg çështjesh të ndjeshme – si zgjidhja e martesës, ndihma për bashkëshorten dhe fëmijën (detyrimi ushqimor), përgjegjësitë prindërore, kujdestaria, dhe ndarja e pasurisë – të cilat pasqyrojnë vlerat dhe normat e shoqërisë që drejtojnë. Në qoftë se norma dhe vlera të tilla karakterizohen nga pabarazitë dhe stereotipet gjinore, kjo u hap rrugën dhe vë në pah qëndrimet dhe stereotipet diskriminuese. ▪ Gratë humbin në procesin e ndarjes së pasurisë pas zgjidhjes së martesës, kryesisht sepse kontratat e nënkuptuara në marrëveshjen e martesës nuk zbatohen. ▪ Numri i burrave që marrin kujdestarinë e fëmijëve në rast të zgjidhjes së martesës është i vogël për shkak të besimit se gratë kujdesen më mirë për fëmijët. ▪ Shumë vendime të gjykatave për kujdestarinë e fëmijëve pas abuzimit nga partneri burrë/bashkëshorti, vazhdojnë t'i japin të drejtën e ushtrimit të përgjegjësive prindërore dhunuesit dhe/ose të drejtën e fëmijës për të pasur kontakt të vazhdueshëm me të dy prindërit.⁷⁵

⁷⁴ Këshilli i Evropës (2017). *Training Manual for Judges and Prosecutors on Ensuring Women's Access to Justice*. (Manual trajnues për gjyqtaret/gjyqtarët dhe prokuroret/prokuroret për sigurimin e aksesit të grave në drejtësi). Shih: <https://rm.coe.int/training-manual-women-access-to-justice/16808d78c5>; Këshilli i Evropës (2018). *Women's Access to Justice: A Guide for Legal Practitioners*. (Aksesi i grave në drejtësi: Një udhëzues për profesionistet/profesionistët ligjorë). See: <https://rm.coe.int/factsheet-womens-access-to-justice/16808ff44e>

⁷⁵ *Po aty*.

Shembuj pozitivë nga BE-ja në lidhje me integrimin gjinor në sektorin e drejtësisë

Court Watch (Monitorimi i gjykatave), Bullgari: Një shembull pozitiv nga shtetet e BE-së në lidhje me integrimin gjinor në sektorin e drejtësisë është zbatimi i metodës së monitorimit të gjykatave për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit mbi mbrojtjen nga dhuna në familje (DHF) në Bullgari. Ky program synonte përmirësimin e efektivitetit të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje në gjykatat e Varnës, dhe në të u përfshinë vullnetare dhe vullnetarë të trajnuar që ndoqën proceset gjyqësore lidhur me dhunën në familje. Vullnetaret dhe vullnetarët monitoruan një grup treguesish, si karakteristikat demografike të viktimave dhe të autorëve të dhunës, nëse u lëshuan vendime për masa mbrojtëse, dhe sa padi penale u tërhoqën ose sa gjykime të tyre u vonuan. Ky proces i monitorimit të gjykatave çoi në uljen e numrit të rasteve të njëanshmërisë dhe diskriminimit, si edhe solli përmirësimin e treguesve si numri i urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, spektri i masave të përfshira në vendimet e formës së prerë, dhe kohëzgjatja mesatare e procedimit të çështjeve.⁷⁶

Rrjeti i Zyrave për Mbështetjen e Viktimave, Spanjë: Një shembull tjetër, nga Spanja, ka të bëjë me praktikën e krijimit të një Rrjeti të Zyrave për Mbështetjen e Viktimave. Këto zyra funksionojnë në bazë të qasjes së angazhimit shumësektorial në qendër të të cilit është viktimja, që synon të ofrojë ndihmë gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe të specializuara për viktimat e krimit, si dhe t'u përgjigjet nevojave të tyre specifike ligjore, psikologjike dhe sociale. Zyrat për Mbështetjen e Viktimave e ofrojnë mbështetjen/ndihmën e tyre në katër faza: pritje-udhëzim, informim, ndërhyrje, dhe ndjekje në vijimësi. Zyrat përgatisin raporte të specializuara për ndihmën individuale që ofrohet dhe këto raporte i përcillen autoriteteve përkatëse të ndjekjes penale dhe gjyqësore, ku shërbejnë si bazë për miratimin e masave të mbrojtjes. Viktimat gjithashtu ndihmohen në procesin e paraqitjes së kërkesave për kompensim.⁷⁷

⁷⁶ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (2022). *Bulgaria's court watch reduces discrimination and delay in the courts* (Monitorimi i gjykatave në Bullgari redukton diskriminimin dhe vonesat në gjykata). Shih: https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/court_watching_in_varna_-_support_services_-_bulgaria.pdf

⁷⁷ Këshilli i Evropës (2022). *Mid-term Horizontal Review of GREVIO baseline evaluation reports*. (Shqyrtimi afatmesëm horizontal i raporteve fillestare të vlerësimit të GREVIO-s). Shih: <https://rm.coe.int/prems-010522-gbr-grevio-mid-term-horizontal-review-rev-february-2022/1680a58499>.

3 LIDHJA E DREJTËSISË ME ACQUIS E BE-SË PËR BARAZINË GJINORE

Integrimi gjinor është një strategji që synon përfshirjen e një **këndvështrimi gjinor** në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, strategjive, buxheteve, programeve të shpenzimeve, aktiviteve të projekteve, masave rregullatore, funksioneve administrative dhe kulturës institucionale, me synim promovimin e **barazisë ndërmjet grave dhe burrave**, si dhe parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit.

Integrimi gjinor siguron që hartimi i politikave dhe puna legjislative të jenë të një cilësie më të lartë dhe që politikat t'u përgjigjen më me efektivitet nevojave të të gjitha/gjithë qytetareve/qytetarëve – gra dhe burra, vajza dhe djem. Me integrimin gjinor, ndërhyrjet publike bëhen më efektive dhe sigurojnë që pabarazitë të mos përsëriten në të ardhmen.

Objektivi kryesor i programeve të BE-së në vendet e (para)anëtarësimit është që shtetet kandidatë të mbështeten në punën për miratimin dhe zbatimin e të gjitha reformave (politike, institucionale, ligjore, administrative, shoqërore dhe ekonomike), të cilat kërkohet të jenë në përputhje me vlerat dhe të përafuara me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së. Kriteret e anëtarësimit (kriteret e Kopenhagës) përmbajnë parakushte të qarta për ekzistencën e institucioneve demokratike që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.⁷⁸ Barazia gjinore, si një prej parimeve kryesore të shtetit ligjor, është pjesë përbërëse e pandarë e Strategjisë së Zgjerimit të BE-së.⁷⁹ Zgjerimi kërkon nga secili vend kandidat për anëtarësim që të miratojë të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta (*acquis* e BE-së), të cilat janë të detyrueshme për të gjitha vendet anëtare të BE-së.⁸⁰ Barazia gjinore është pjesë përbërëse e proceseve të anëtarësimit dhe të harmonizimit të legjislacionit, përmes zbatimit të këtyre parimeve që burojnë nga qasja e bazuar në të drejtat e njeriut: (i) ligjshmëria, universaliteti dhe pandashmëria e të drejtave të njeriut; (ii) pjesëmarrja; (iii) mosdiskriminimi; (iv) llogaridhënia dhe përgjegjshmëria; dhe (v) transparenca në çdo hap të programimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të mbështetjes së BE-së.

78 Përfundimet e Presidencës së Këshillit Evropian, Kopenhagë, 21-22 qershor 1993. Shih: <https://www.consilium.europa.eu/media/21225/72921.pdf>

79 Komunikatë e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Komitetit të Rajoneve. *A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans, 2018*. (Një perspektivë e besueshme për zgjerimin dhe rritjen e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor, 2018), f.4. E disponueshme në: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

80 Shih: <https://eur-lex.europa.eu/summary/glossary/acquis.html>

Në nivelin e BE-së, detyrimi për t'u angazhuar për integrimin gjinor buron, ndër të tjera, nga:

- Traktati i Bashkimit Evropian (TBE);⁸¹
- Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)⁸² nenet 8 dhe 10, ku përcaktohen detyrimet e BE-së dhe të shteteve anëtare për të siguruar përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të gjitha veprimtaritë e BE-së;
- Direktiva 2004/113/EC e Këshillit e datës 13 dhjetor 2004⁸³, 'Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve';
- Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 5 korrik 2006⁸⁴ 'Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim' (Direktiva e rishikuar).

Gjithashtu, integrimi gjinor është i pasqyruar qartësisht në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së (2021-2025)⁸⁵ dhe është pjesë përbërëse e Rregulloreve të Instrumentit të Asistencës së Para - Anëtarësimit të BE-së (IPA III)⁸⁶:
për t'u anëtarësuar në BE, vendeve kandidatë u kërkohet që të përmbushin detyrimet e përcaktuara në *acquis* për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.

81 Version i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012M%2FTXT>

82 Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012E%2FTXT>

83 Direktivë e Këshillit Nr. 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004, '*Implementing the principle of equal treatment between men and women in the access to and supply of goods and services*'. (Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32004L0113>

84 Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 5 korrik 2006 '*On the implementation of the principle of equal opportunities and equal treatment of men and women in matters of employment and occupation*' (Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në punësim) (Direktiva e rishikuar). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32006L0054>

85 Komisioni Evropian (2020). Komunikatë e përbashkët e Parlamentit Evropian dhe Këshillit: 'Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në veprimin e jashtëm të BE-së'. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020JC0017>

86 Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale; ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

Në nivel ndërkombëtar, Shqipëria është palë nënshkruese ose ka ratifikuar traktatet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare sipas të cilave vendi ka detyrimin të mbrojtë dhe të mbështesë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, përfshirë:

- Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW të UN);⁸⁷
- Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit);⁸⁸
- Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit (BPfA);⁸⁹
- Rezolutën 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ‘Gratë, paqja dhe siguria’ (UNSCR 1325);⁹⁰ dhe
- Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)⁹¹, dhe Konventën C190 të ILO lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës.⁹²

Ligji i BE-së për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III i BE-së janë të përafuara me dokumentet e lartpërmendura dhe si të tillë përbëjnë një pjesë integrale të procesit të anëtarësimit në BE.

Në nivel kombëtar, Kushtetuta e Shqipërisë ndalon diskriminimin me bazë gjinore (Neni 18/2).⁹³ Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në

87 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (1979). Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Shih: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-elimination-all-forms-discrimination-against-women>

88 Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (2011). Shih: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/home?>

89 Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (1995). Shih: <https://awenetwork.org/media/6462066697d99.pdf>

90 Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara “Gratë, paqja dhe siguria” (2000). Shih: <https://www.unwomen.org/en/docs/2000/10/un-security-council-resolution-1325>

91 Konventat dhe rekomandimet e ILO-s (në internet). Shih: <https://www.ilo.org/global/standards/introduction-to-international-labour-standards/conventions-and-recommendations/lang--en/index.htm>

92 ILO (2019). Konventa nr. 190 lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës: https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:12100:0::NO::P12100_ILO_CODE:C190; Shih gjithashtu: https://www.academia.edu/45637174/KONVENTA_NR_190_MBI_DHUN%C3%8BN_DHE_NGACMIMIN_N%C3%8B_BOT%C3%8BN_E_PUN%C3%8BS

93 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Shih: <https://www.osce.org/albania/41888>

shoqëri”⁹⁴ përkufizon termin “integrim gjinor”. Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar në vitin 2020⁹⁵, detyron të gjitha autoritetet publike të promovojnë barazinë dhe të parandalojnë diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (neni 7, “Mbrojtja nga diskriminimi”). Për më tepër, ligji trajton diskriminimin strukturor dhe diskriminimin për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination), si dhe eliminimin e privilegjeve.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2021-2030, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.06.2021, në qëllimin strategjik IV përcakton ‘Aplikimin e integritit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri’.⁹⁶ Ajo parashikon monitorimin e strategjive të reja të cilat duhet të integrojnë këndvështrimin gjinor, si dhe caktimin e buxheteve përkatëse në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, SKBGJ-ja përcakton kuadrin strategjik për integrimin gjinor në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes.

3.1. Përafrimi me Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP) III të BE-së dhe treguesit përkatës

Sikurse evidentohet në dokumente si raportet dhe dosjet gjinore për Shqipërinë, në vend vazhdojnë të ekzistojnë mangësi të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve të pabarazisë gjinore dhe në zbatimin e integritit gjinor.⁹⁷ Këtu përfshihen fusha të politikave në të cilat statusi i pabarabartë i grave është i mirëdokumentuar dhe i vërtetuar qartë nga të dhënat administrative. Ndër arsyet bazë për këtë janë:

94 Ligji nr.9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 125, datë 01.08.2008. Shih: <http://www.osce.org/albania/36682>

95 Ndryshuar me Ligjin nr. 124/2020. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/191/4a6fb792-6c8d-4637-ba0f-fa0ece007562>

96 Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr.112, datë 15.07.2021. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112>. Versioni në gjuhën angleze gjendet në: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

97 Komisioni Evropian. Raportet e BE-së për Shqipërinë më 2017, 2018, 2019 dhe 2020; UNDP dhe UN Women (2016). *Gender Brief Albania* (Dosja Gjinore Shqipëri). Shih: <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>; UN Women 2020. *Albania Country Gender Equality Brief*. (Dosja e Barazisë Gjinore e Shqipërisë, 2020). Shih: [https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020#:~:text=The%20purpose%20of%20UN%20Women's,Sustainable%20Development%20Goals%20\(SDGs\)](https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020#:~:text=The%20purpose%20of%20UN%20Women's,Sustainable%20Development%20Goals%20(SDGs))

- (i) konceptualizimi stereotipik dhe i gabuar i 'qytetarit të zakonshëm', i cili është burrë;
- (ii) kapacitete dhe aftësi të kufizuara për integrimin gjinor në administratë;
- (iii) mungesa e detyrimit për të kryer analiza gjinore të rregullta, sipas fushave të politikave; dhe
- (iv) pasqyrimi i dobët i normave dhe standardeve gjinore në proceset, procedurat dhe sistemet e qeverisjes.

Një pengesë e mëtejshme është fakti se individët e përfshirë në hartimin e politikave dhe programeve e kanë të vështirë të përcaktojnë saktësisht se cilat janë çështjet gjinore kryesore në fushat konkrete të punës dhe veprimtarisë së tyre. Si rrjedhojë, shumica dërrmuese e politikave, planeve dhe programeve mbeten pa objektiva konkrete për barazinë gjinore.

Politikat publike hartohen dhe zbatohen me synimin e arritjes së rezultateve të caktuara. Treguesit përvijojnë aspektet rregullatore të arritjes së këtyre rezultateve. Për sa i përket monitorimit të përparimit të bërë në fushën e barazisë gjinore, treguesit e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025 të BE-së mund të shërbejnë si udhërrëfyes të vlefshëm.⁹⁸ Ata ilustrojnë se çfarë ndryshimi (pra, çfarë rezultatesh) është i nevojshëm të arrihet dhe të matet në jetën e grave/vajzave dhe burrave/djemve, në një fushë të caktuar të politikave.

Në GAP III të BE-së pabarazitë gjinore në sektorin e drejtësisë trajtohen kryesisht në Fushën Tematike 1 "Sigurimi i lirisë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore" dhe në Fushën Tematike 4 "Nxitja e pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së barabartë".

Për Fushën Tematike 1 të GAP III të BE-së, objektivi i përgjithshëm tematik synon një ndryshim të nivelit të ndikimit nëpërmjet:

- rritjes së mbrojtjes – përmes mbështetjes së legjisllacionit që penalizon të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe forcimit të kapaciteteve

⁹⁸ Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë (2020). *JOINT STAFF WORKING DOCUMENT Objectives and Indicators to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*. (DOKUMENT I PËRBASHKËT I PUNËS SË STAFIT Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore III 2021-25), f.27. Gjendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0284>

të të gjitha institucioneve ligjzbatuese në përputhje me kuadrin ndërkombëtar ligjor dhe politik;

- kontributit për rritjen e numrit të procedimeve të autorëve veprave penale, ndër të cilët ata të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore, duke forcuar qasjen me në qendër viktimën në punën e organeve ligjzbatuese;
- rritjes së mbrojtjes për të mbijetuarat e dhunës, ndër të tjera edhe përmes mbështetjes së aksesit në shërbimet sociale dhe të drejtësisë në situata rreziku për jetën, duke zbatuar një qasje që ve në qendër të mbijetuarat, sidomos ato në situata të vështira apo situata konflikti/paskonflikti, ose kur të mbijetuarat përballen me diskriminime të shumëfishta (intersecting discriminations).

Për Fushën Tematike 4 të GAP III të BE-së, objektivi i përgjithshëm tematik për drejtësinë synon një ndryshim të nivelit të ndikimit nëpërmjet:

- shtimit të kapacitetit dhe aksesit të barabartë ligjor për gratë në drejtësi, përmes mbështetjes së përpjekjeve në terren dhe reformave të sistemeve ligjore dhe të drejtësisë.

Në kuadrin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, integrimi i barazisë gjinore kërkon që objektivat dhe treguesit e GAP III të BE-së të përfshihen gradualisht në kuadrin e politikave të vendit. Për këtë qëllim, tabela në vijim paraqet përafrimin ndërmjet (i) kapitujve përkatës të BE-së për një fushë të caktuar politikash; (ii) dokumenteve përkatëse të politikave kombëtare që do të përshtaten me konsideratat e BE-së për barazinë gjinore; dhe (iii) objektivave dhe treguesve konkretë të GAP III të BE-së që duhet të përfshihen në kornizat kombëtare të monitorimit. Përafrimi plotësohet me listën e treguesve të OZHQ-ve të lidhur me gjininë, të cilët bëjnë lidhjen midis integritimit gjinor në procesin e anëtarësimit në BE me objektivat e barazisë gjinore në nivel global.

TABELA 2

Përafrimi i Kapitullit 23 me treguesit e GAP III të BE-së

Kapitulli 23 – Sistemi gjyqësor dhe të drejtat themelore	
<p>Dokumentet strategjike kombëtare përkatëse</p>	<p>Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i saj i Veprimit 2021-2030</p> <p>Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plani i saj i Veprimit 2021-2025</p> <p>Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2020 - 2023</p> <p>Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023</p> <p>Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025</p> <p>Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI+ 2021-2027</p> <p>Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019 - 2022</p>
<p>Objektivi i Përgjithshëm Tematik përkatës i GAP III të BE-së (impakti)</p>	<p>Fusha Tematike 1: Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë janë të lirë nga çdo formë e dhunës me bazë gjinore në sferat publike dhe private, në vendin e punës dhe në internet</p> <p>Fusha Tematike 4: Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, marrin pjesë në mënyrë të barabartë në proceset e vendimmarrjes, në të gjitha sferat dhe në të gjithë nivelet e jetës politike dhe publike, përfshirë edhe në internet, marrin role udhëheqëse, gëzojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre të njeriut dhe kërkojnë vënien në vend të drejtësisë në rast të mohimit të këtyre të drejtave</p>

<p>Objektivat tematike përkatëse të GAP III të BE-së</p>	<p>Fusha Tematike 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objektivi tematik specifik 1: Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, janë më të mbrojtura/mbrojtur nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në sferat publike dhe private, në vendin e punës dhe në internet, përmes legjislacionit dhe zbatimit efektiv të tij - Objektivi tematik specifik 3: Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, të cilat/cilët përjetojnë dhunë me bazë gjinore, kanë më shumë akses në shërbime thelbësore dhe mbrojtje - Objektivi tematik specifik 8: Mbledhja dhe përdorimi gjithnjë e më shumë i të dhënave cilësore të ndara sipas kategorive dhe të krahasueshme në nivel botëror, lidhur me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe të praktikave të dëmshme, të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e ligjeve, politikave dhe programeve <p>Fusha Tematike 4:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objektivi tematik specifik 2: Gratë dhe vajzat, në gjithë diversitetin e tyre, kanë akses më të mirë në drejtësi për mbrojtjen e të drejtave të tyre civile dhe politike
<p>Treguesit përkatës në GAP III të BE-së</p>	<p>Treguesit e ndikimit për Fushën Tematike 1:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Proporcioni i grave dhe vajzave të moshës mbi 15 vjeç që kanë partnerë dhe që kanë përjetuar dhunë fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike nga një partner intim i tanishëm ose i mëparshëm gjatë 12 muajve të fundit, sipas formës së dhunës dhe sipas moshës - Proporcioni i grave dhe vajzave të moshës mbi 15 vjeç që kanë përjetuar dhunë seksuale nga persona që nuk janë partnerë të tyre intimë gjatë 12 muajve të fundit, sipas moshës dhe vendit ku ka ndodhur dhuna - Numri i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për 100.000 banorë, sipas seksit, moshës dhe formës së shfrytëzimit

Fusha Tematike 1: Treguesit që lidhen me objektivat tematikë specifike

Objektivi 1:

- % e rasteve të referuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale ndaj grave dhe fëmijëve që janë hetuar dhe për të cilat është dhënë dënim (KR-IPJ)
- Niveli i alokimit të burimeve nga institucionet shtetërore dhe strukturat e drejtësisë për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore (Objektivi strategjik 2.2, i ndryshuar)
- Numri i veprimeve legjislative të ndërmarra në shtetin partner për penalizimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë atë në internet, dhe për ndjekjen penale të autorëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare
- Numri i veprimeve legjislative të ndërmarra në shtetin partner për të siguruar që të mbijetuarat/të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore të kenë akses në drejtësi

Objektivi 2:

- Proporcioni i grave të grupmoshës 20-24 vjeç që janë martuar apo kanë bashkëjetuar para moshës 15 vjeç dhe para moshës 18 vjeç
- Proporcioni i njerëzve që mendojnë se është e përligjur që një person të ushtrojë dhunë ndaj partneres/partnerit intim, sipas gjinisë dhe moshës së personit të intervistuar
- Numri i veprimeve për ndërhyrje parandaluese dhe programeve të trajtimit të autorëve të dhunës me bazë gjinore për të mos lejuar recidivimin

Objektivi 3:

- % e grave, përfshirë ato që përballen me forma të ndërthurura dhe të shumëfishta të diskriminimit, që raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale, të cilat kërkojnë ndihmë, sipas sektorit, domethënë (a) shërbime të ofruara nga institucione shtetërore dhe të shoqërisë civile; ose (b) shërbime të mirëqenies sociale, **ndihmë ligjore**, strehim, mbrojtje nga policia

	<ul style="list-style-type: none"> - % e rasteve të dhunës me bazë gjinore të raportuara në polici që janë çuar në gjykatë dhe kanë rezultuar në dënimin e autorëve të dhunës, ndarë më së paku sipas seksit - Shkalla në të cilën rriten kapacitetet e institucioneve të shtetit partner për të luftuar dhunën me bazë gjinore - Numri i rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore (DHSBGJ) të raportuara në polici, çdo vit, ndarë më së paku sipas seksit - % e rasteve të dhunës me bazë gjinore të raportuara në polici, çdo vit, ndarë më së paku sipas seksit - % rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore të raportuara në polici që janë çuar në gjyq, çdo vit, ndarë më së paku sipas seksit - Numri i rasteve të dhunës me bazë gjinore në internet, i ngacmimeve dhe bullizmit kibernetik që vënë në shënjestër gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetin e tyre, të raportuara në polici çdo vit, ndarë më së paku sipas seksit <p>Objektivi 5:</p> <ul style="list-style-type: none"> - % e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të trafikimit të intervistuar/intervistuar nga një punonjëse/punonjës i policisë që ka marrë pjesë në trajnim lidhur me qasjen me në qendër viktimën, ndarë më së paku sipas seksit - % e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të trafikimit të intervistuar/intervistuar në një dhomë vizitash të sigurt dhe private, ndarë më së paku sipas seksit - Numri i masave të marra nga qeveria (pra masa mbrojtëse, parandaluese, ndjekja penale e trafikantëve, bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve kryesorë, njohuritë) për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore <p>Objektivi 6:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkalla në të cilën organet homologe vendore (përfshirë institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë) veprojnë për të parandaluar dhe luftuar dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore
--	---

	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i refugjateve/refugjatëve në shtetin partner që përfitojnë nga shërbimet shtetërore dhe të shoqërisë civile, ndarë më së paku sipas seksit - Shkalla në të cilën institucionet ligjzbatuese, forcat e sigurisë dhe organet e drejtësisë e njohin dhe përfshijnë perspektivën gjinore në reagimet e tyre - Shkalla në të cilën politikat dhe veprimet e organeve homologe vendore kontribuojnë për rritjen e numrit të grave të punësuar në organet ligjzbatuese, forcat e sigurisë apo institucionet e drejtësisë <p>Objektivi 8:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkalla në të cilën zyra kombëtare e statistikave, policia, sektori i drejtësisë, institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera të shtetit partner mbledhin të dhëna cilësore dhe të krahasueshme në nivel botëror, të ndara të paktën sipas seksit dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, lidhur me përhapjen dhe incidencën e dhunës me bazë gjinore dhe praktikrat e dëmshme, kur është relevante - Shkalla në të cilën mbledhja e të dhënave mbi përhapjen dhe incidencën e dhunës me bazë gjinore është e bashkërenduar ndërmjet aktorëve kryesorë - Shkalla në të cilën të dhënat mbi përhapjen dhe incidencën e dhunës me bazë gjinore analizohen dhe botohen në nivel kombëtar dhe/ose në nivele të decentralizuara - Shkalla në të cilën të dhënat mbi përhapjen dhe incidencën e dhunës me bazë gjinore shërbejnë si bazë për hartimin e politikave dhe vendimmarrje <p>Fusha Tematike 4, Treguesit e objektivit tematik specifik 2</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nëse ekzistojnë apo jo korniza ligjore për promovimin, zbatimin dhe monitorimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në bazë të seksit - Shkalla në të cilën rishikohet legjislacioni për të hequr klauzolat diskriminuese gjinore mbi familjen, zgjidhjen e martesës, kujdestarinë e fëmijëve, trashëgiminë, punësimin, pagën, sigurimet shoqërore, zotërimin e pronave dhe të tokës, etj.
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - % e popullsisë që mendojnë se cilësia e drejtësisë që ofrohet është përgjithësisht e mirë ose shumë e mirë, ndarë më së paku sipas seksit - Proporcioni i popullsisë që raporton se është ndjerë personalisht e/i diskriminuar ose e/i ngacmuar në 12 muajt e fundit, për një arsye diskriminimi që ndalohet në bazë të të drejtave ndërkombëtare të njeriut - Numri i konsultimeve në nivel kombëtar dhe vendor nga autoritetet qeveritare partnere me organizatat e të drejtave të grave të angazhuara në fushën e avokatisë për reforma në drejtësi
<p>Treguesit e OZHQ-ve të lidhur me gjininë</p>	<p>5.1.1. Nëse ekzistojnë apo jo korniza ligjore për promovimin, zbatimin dhe monitorimin e barazisë dhe mosdiskriminimit në bazë të seksit</p> <p>5.a.1. Proporcioni i njerëzve me pronësi ose me tituj të garantuar mbi tokën bujqësore (nga e gjithë popullsia që merret me bujqësi), sipas seksit (%)</p> <p>5.a.1. Proporcioni i grave ndër pronaret/pronarët ose titujmbajtëset/ titujmbajtësit e tokës bujqësore, sipas llojit të titullit (%)</p> <p>5.a.2. Shkalla në të cilën kuadri ligjor (përfshirë të drejtën zakonore) garanton të drejta të barabarta të grave të pronësisë dhe/ose kontrollit mbi tokën (1= nuk ka dëshmi se ekzistojnë garanci, deri në 6 = niveli më i lartë i garancive)</p> <p>5.6.2. Shkalla në të cilën shtetet kanë ligje dhe rregullore që garantojnë aksesin e plotë dhe të barabartë të grave dhe burrave të moshës 15 vjeç e lart në shërbime, informacion dhe edukim mbi shëndetin seksual dhe riprodhues (%)</p> <p>5.3.1. Proporcioni i grave të grupmoshës 20-24 vjeç që janë martuar apo kanë bashkëjetuar para moshës 15 vjeç dhe para moshës 18 vjeç</p>

3.2. Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) III: integrimi gjinor sipas ‘Rregulloreve të NDICI-it’

Agjenda e Shqipërisë për reforma dhe anëtarësim merr mbështetje të konsiderueshme financiare përmes fondeve të BE-së, si edhe drejtpërdrejt nga shtetet anëtare të BE-së. Bashkimi Evropian, si promovuesi kryesor i barazisë ndërmjet grave dhe burrave në rajon, ka përcaktuar standarde të qarta dhe të përkufizuara shprehimisht në Rregulloret e ‘Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar’ (NDICI) të Komisionit Evropian që u miratuan në qershor 2021.⁹⁹ Këto rregullore vlejné edhe për veprimtaritë në kuadër të IPA III të BE-së që do të financohen dhe zbatohen në Shqipëri dhe formulojné shprehimisht kriteret e barazisë gjinore:

“[...] Forcimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave në veprimin e jashtëm të Bashkimit [Evropian] dhe shtimi i përpjekjeve për të arritur standardet minimale të performancës që përcaktohen në Planet e Veprimit për Barazinë Gjinore të BE-së, duhet të çojné në një qasje me ndjeshmëri gjinore dhe transformuese në të gjithë veprimin e jashtëm dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të BE-së. Të paktën 85% e veprimeve të reja që do të zbatohen në kuadër të këtij instrumenti duhet të kenë barazinë gjinore si objektivi parësor ose të rëndësishëm, sikurse përkufizohet në vlerësuesin e politikave për barazinë gjinore të Komitetit të Asistencës për Zhvillim (DAC) të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD-së). Të paktën 5% e këtyre veprimeve duhet të kenë si objektivi parësor barazinë gjinore, të drejtat dhe fuqizimin e grave dhe vajzave.”

Nën dritën e Rregulloreve të NDICI-t, të cilat parashikojné objektivin prej 85 për qind veprime me ndjeshmëri gjinore në të ardhmen, qeveria e Shqipërisë duhet të përcaktojë – në terma konkrete – veprimtaritë, strukturat, mekanizmat dhe kapacitetet për zbatimin e veprimeve me ndjeshmëri gjinore, që është kriter dhe parakusht për suksesin në marrjen e fondeve nga IPA III e BE-së.

3.3. Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i OECD-DAC

Vlerësuesi i politikave për barazinë gjinore i Komitetit të Asistencës së Zhvillimit të Organizatës së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OECD-DAC)¹⁰⁰

99 Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale; ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 466/2014/EU dhe shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32021R0947&from=EN>

100 OECD DAC Network on Gender Equality (GENDERNET) (2016). *Definition and minimum recommended criteria for the DAC gender equality policy marker*. (Përkufizimi dhe kriteret minimale të rekomanduara për vlerësuesin e politikave të barazisë gjinore të DAC). Shih: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/Minimum-recommended-criteria-for-DAC-gender-marker.pdf>

është një instrument tepër i rëndësishëm për kryerjen e monitorimit dhe sigurimin e llogaridhënies në kontekstin e Agjendës 2030. Qëllimi i tij është që të identifikojë mangësitë midis angazhimeve ligjore, politike dhe financiare dhe të nxisë përpjekjet për eliminimin e tyre. Për të gjitha programet/veprimet është e detyrueshme kryerja e një analize gjinore dhe ndjekja e qasjes 'mos shkakto dëm'.

Programet/veprimet që janë shqyrtuar kundrejt kritereve të këtij vlerësuesi dhe janë konstatuar se nuk e përmbajnë si synim barazinë gjinore, klasifikohen në kategorinë me 0 pikë. Vlerësimi me 0 pikë duhet të shoqërohet me një shpjegim përshkruar. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por nuk është arsyeja kryesore për kryerjen e programit/veprimit, klasifikohen me 1 pikë. Programet/veprimet në të cilat barazia gjinore është objektiv kryesor dhe themelor qoftë në hartimin, ashtu edhe në rezultatet e pritshme të tyre, klasifikohen me 2 pikë.

Në Rregulloret e NDICI-t të BE-së – të cilat janë të zbatueshme, për shembull, për Dokumentet e Veprimit të IPA III - përmendet shprehimisht detyrimi për zbatimin e kritereve minimale të përbashkëta për tri kategoritë e vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së. Ato përcaktojnë objektivin që më së paku 85 për qind e të gjitha veprimeve të ndërmarra duhet të përmbushin kriteret për t'u klasifikuar në kategorinë 1, dhe 5 për qind të përmbushin kriteret e kategorisë 2. Në praktikë, klasifikimi me 1 pikë kërkon që veprimet me përgjigjshmëri gjinore të pasqyrohen në nivelin e analizës së problemeve, objektivave, treguesve dhe arritjeve të synuara.

Përkufizimi i Kategorisë 1:

- Barazia gjinore është objektiv i rëndësishëm dhe i qëllimshëm, por jo arsyeja kryesore për kryerjen e projektit/programit.
- Objektivi i barazisë gjinore duhet të jetë i formuluar shprehimisht në dokumentacionin e projektit/programit dhe nuk mund të jetë i nënkuptuar apo të merret me mend.
- Krahas objektivave të tjera, projekti/programi synon të ketë një ndikim pozitiv në përparimin e mëtejshëm të barazisë gjinore dhe/ose të fuqizimit të grave dhe vajzave, redukton diskriminimin gjinor ose pabarazitë, ose plotëson nevoja gjinore specifike.

TABELA 2

Kërkesat minimale për përmbushjen e kritereve të Kategorisë 1 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të OECD-DAC

Niveli	Kriteri	Përmbushja	Veprimi që duhet ndërmarrë për arritjen e tij
Analiza e Problemit	Është kryer një analizë e statusit, rolit, pozicionit dhe gjendjes së grave/vajzave dhe burrave/djemve në lidhje me një fushë të politikave/ sektor/ nënsektor ku është ndërmarrë projekti/programi/veprimi	<input type="checkbox"/>	Në rastet kur analiza gjinore nuk ekziston, ose është e paplotë apo i ka kaluar koha, duhet të porositet/ të ndërmerret një analizë gjinore specifike për sektorin ose nënsektorin
	Konstatimet e nxjerra nga analiza gjinore:		
	- janë përfshirë në përshkrimin e problemit	<input type="checkbox"/>	
	- mbështeten me shifra (statistika gjinore)	<input type="checkbox"/>	
	- janë marrë për bazë në hartimin e projektit/ programit/veprimit	<input type="checkbox"/>	
	Janë përmendur çështjet kryesore të pabarazisë gjinore në fushën e politikave/sektorin/ nënsektorin konkret	<input type="checkbox"/>	
	Ndërhyrja i përmbahet qasjes “mos shkakto dëm”	<input type="checkbox"/>	
	Të dhënat statistikore dhe treguesit janë ndarë sipas seksit dhe sipas tipareve të tjera të identitetit, aty ku është e zbatueshme	<input type="checkbox"/>	

Objektivat	Prania e të paktën një objektivi të barazisë gjinore (për shembull, formulimi shprehimisht i synimit për arritjen e objektivave të barazisë gjinore), në përputhje me problemet e pabarazisë gjinore të identifikuar dhe detajuara në analizën përshkuese	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Veprimtaritë	Veprimtaritë e propozuara i përgjigjen posaçërisht situatës së përshkruar të grave/vajzave dhe burrave/djemve, kontribuojnë në arritjen e rezultateve të barazisë gjinore dhe parandalojnë diskriminimin, përfshirë diskriminimin strukturor dhe atë për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination)	□	Përfshirja e ekspertizës për integrimin gjinor si pjesë përbërëse e grupeve të punës që hartojnë/ rishikojnë dokumentet
Treguesit	Objektivi ose objektivat e barazisë gjinore mbështeten me të paktën një tregues me ndjeshmëri gjinore, që mundëson: <ul style="list-style-type: none"> - identifikimin e dallimeve gjinore në përfitimet nga masat e parashikuara - monitorimin e ndikimit të masave/veprimtarive mbi gratë/vajzat dhe burrat/djemtë 	□	Harmonizimi me treguesit përkatës të BE-së dhe ata globalë (si për shembull, OZHQ-të, Eurostat/GAP III i BE-së, dhe të tjerë të ngjashëm)

Rezultatet e synuara	Caktohen vlera specifike të matshme për gratë /vajzat dhe burrat/djemtë	□	Reflektimi i qëllimit për eliminimin e dallimeve gjinore/ për arritjen e rezultateve në fushën e barazisë gjinore në vlerat që vendosen për matjen e rezultateve të synuara
-----------------------------	---	---	---

Për t'u klasifikuar në kategorinë 2 të vlerësuesit të politikave për barazinë gjinore të DAC të OECD-së, barazia gjinore duhet të jetë objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe për sa i përket rezultateve të pritshme. Deri tani, numri dhe fushëveprimi i projekteve të financuara në kuadrin e IPA të BE-së që klasifikohen në Kategorinë 2 është shumë i ulët.

Përkufizimi i Kategorisë 2:

- Barazia gjinore është objektivi kryesor dhe themelor i projektit/programit, si në hartimin e tij ashtu edhe në rezultatet e pritshme. Projekti/programi nuk do të ishte ndërmarrë pa këtë objektiv të barazisë gjinore.
- Synimi parësor dhe kryesor në hartimin e projektit/programit është përparimi i mëtejshëm i barazisë gjinore dhe/ose i fuqizimit të grave dhe vajzave, reduktimi i diskriminimit ose pabarazive, ose plotësimi i nevojave gjinore specifike.

4 MJETET KRYESORE PËR INTEGRIMIN GJINOR

Ky seksion përmban një numër mjeteve të standardizuara të BE-së për integrimin gjinor që mund të përdoren në rishikimin e politikave, planifikimet strategjike të ministrive të linjës, në programim, hartimin e buxheteve dhe në procese të tjera qeverisëse të ngjashme. Lista e plotë e mjeteve dhe materialeve burimore të standardizuara të BE-së, ku përfshihen edhe përshkrime të hollësishme të mjeteve për integrimin gjinor, gjendet (në gjuhën angleze) në faqen e internetit të Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE), në këtë adresë: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools>

4.1. Analiza gjinore¹⁰¹

Analiza gjinore ofron të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për integrimin gjinor në politika, programe dhe projekte. Si procesi që përbën pikënisjen për integrimin gjinor, analiza gjinore identifikon dallimet ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve për sa i përket pozicionit të tyre relativ në shoqëri dhe shpërndarjes së burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit në një kontekst të caktuar. Në këtë mënyrë, kryerja e analizës gjinore bën të mundur zhvillimin e ndërhyrjeve të mëtejshme që trajtojnë siç duhet pabarazitë gjinore dhe plotësojnë nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi i analizës gjinore është të identifikojë dhe të trajtojë pabarazitë gjinore, përmes:

- pranimit të ekzistencës së dallimeve ndërmjet dhe në radhët e grave/vajzave dhe burrave/djemve bazuar në shpërndarjen e pabarabartë të burimeve, mundësive, kufizimeve dhe pushtetit,
- marrjes së masave që nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve të jenë identifikuar dhe trajtuar qartë në të gjitha fazat e ciklit të politikave,
- pranimit se politikat, programet dhe projektet kanë ndikim të ndryshëm tek gratë/vajzat dhe burrat /djemtë,
- kërkimit dhe formulimit të mendimeve të grave/vajzave dhe burrave/djemve dhe përfshirjes së kontributeve të tyre si komponentë të rëndësishëm në zhvillimin e politikave, programeve dhe projekteve,
- nxitjes së pjesëmarrjes dhe përfshirjes së grave në jetën e komunitetit, jetën politike dhe ekonomike,
- mbështetjes së ndërhyrjeve që promovojnë barazinë gjinore, të bazuara në të dhëna dhe informacion të besueshëm.

¹⁰¹ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Në internet]. *Gender Mainstreaming Methods and Tools*. (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor). I disponueshëm në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-analysis#:~:text=As%20a%20starting%20point%20for,power%20in%20a%20given%20context>

Analiza gjinore përfshin marrjen parasysh të përvojave, roleve dhe përgjegjësi të veçanta të grave, dhe shkallën e aksesit të tyre në burime dhe në vendimmarrje. Analiza gjinore përfshin gjithashtu njohjen e pabarazive historike dhe shoqërore me të cilat përballen gratë/vajzat dhe synon të shërbejë si informacion bazë për hartimin e politikave, programeve dhe projekteve që trajtojnë – dhe i ndreqin – këto pabarazi.

Kryerja e një analize gjinore të thelluar dhe të gjithanshme bën të mundur që politikëbërëset/ politikëbërësit të kuptojnë pabarazitë gjinore në një kontekst apo sektor të caktuar: ajo bën përshkrimin e stadi aktual të situatave kontekstuale sipas gjinisë, si edhe shqyrton shkaqet dhe pasojat e dallimeve gjinore në grupin e synuar. Shqyrtimi i arsyeve që qëndrojnë në themel të pabarazive dhe diskriminimit gjinor ndihmon në përcaktimin e objektivave dhe masave përkatëse të fokusuara për eliminimin e pabarazive gjinore. Në këtë mënyrë, analiza gjinore kontribuon në përmirësimin e përgjigjshmërisë gjinore të politikave dhe legjislacionit, sepse ofron bazën për të siguruar trajtimin e duhur të nevojave të të gjitha/gjithë qytetareve/qytetarëve: grave, burrave, vajzave dhe djemve.

4.2. Statistikat gjinore mbi drejtësinë në kontekstin shqiptar

Statistikat gjinore përshkruajnë ose matin pabarazitë gjinore. Ato mbështeten në të dhëna për individët, të ndara sipas seksit, pra të dhëna që mbliidhen dhe kategorizohen veçmas për gratë/vajzat dhe burrat /djemtë. Këto të dhëna të ndara sipas seksit pasqyrojnë realitetet e jetës së grave/vajzave dhe burrave/djemve, si dhe çështje të politikave që lidhen me gjininë. Ato bëjnë të mundur matjen e dallimeve ndërmjet grave dhe burrave në aspekte të ndryshme shoqërore dhe ekonomike dhe janë të domosdoshme për sigurimin e statistikave gjinore. Për të monitoruar përparimin faktik në fushën e barazisë gjinore, konceptet, përkufizimet dhe metodat e përdorura në prodhimin dhe analizimin e të dhënave duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë rolet, marrëdhëniet dhe pabarazitë gjinore në shoqëri.¹⁰²

Në Shqipëri, statistikat gjinore botohen çdo vit, përmes publikimit të posaçëm të INSTAT-it për këtë qëllim me titull 'Gra dhe Burra në Shqipëri'.¹⁰³ Objektivi kryesor i këtij botimi është që të vërë në dispozicion të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistika

102 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Në internet]. *Gender Mainstreaming Methods and Tools – Sex-disaggregated data*. (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor – të dhëna të ndara sipas seksit). I disponueshëm në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/sex-disaggregated-data#:~:text=Data%20collected%20and%20tabulated%20separately,requirements%20in%20obtaining%20gender%20statistics>

103 Shih: <http://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-indicators/gender-equality/#tab3>

gjinore për të mundësuar monitorimin e politikave ndërsektoriale në kuadër të arritjes së objektivave të barazisë gjinore dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Në botim përfshihen jo vetëm të dhëna administrative, por edhe të dhëna të bazuara në vrojtimit sociale që kryen INSTAT-i në nivelin e njësisë familjare.

Një nga studimet përkatëse që lidhen me fushën e drejtësisë është vrojtimi kombëtar mbi dhunën me bazë gjinore që INSTAT-i e kryen një herë në pesë vjet që prej vitit 2007. Ndërsa vrojtimit e viteve 2007 dhe 2013 u përqendruan vetëm tek dhuna në familje, vrojtimi i fundit, që u botua në mars të vitit 2019, mbledhi për herë të parë të dhëna mbi natyrën dhe përhapjen e formave të tjera të dhunës: dhuna në lidhje dashurie, dhuna nga jopartneri, ngacmimi seksual dhe përndjekja.¹⁰⁴ Në të u paraqitën konstatime edhe mbi normat sociale mbizotëruese që lidhen me dhunën ndaj grave. Me kalimin e viteve, metodologjia¹⁰⁵ dhe pyetësi i përdorur për vrojtimit janë modifikuar gradualisht, për harmonizimin e tyre të plotë me kriteret e Eurostatit.¹⁰⁶ Të dhënat dhe treguesit e tanishëm janë të krahasueshëm me ato që përdoren nga shtetet e BE-së.

Përpyekjet e INSTAT-it për harmonizimin e statistikave gjinore kombëtare me ato të Eurostatit janë një proces i pandërprerë dhe që vazhdon edhe sot. Në vitin 2021, baza e të dhënave e INSTAT-it u ristrukturua në përputhje me metodologjinë dhe bazën e të dhënave të Eurostatit. Të gjitha të dhënat administrative u vlerësuan kundrejt treguesve të Eurostatit; gjithashtu prodhimi i treguesve të vrojtimit sociale u bë mbi bazën e një metodologjie të njësuar. Është e rëndësishme të theksohet se harmonizimi në vijimësi i statistikave – përfshirë edhe statistikat gjinore – nuk është kërkesë vetëm për INSTAT-in; ajo është kërkesë për të gjitha institucionet që prodhojnë statistika në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes.

Për sa u përket të dhënave administrative për drejtësinë, një numër institucioneesh mbledhin dhe nxjerrin raporte të rregullta që përfshijnë të dhëna përkatëse për gjininë. Këto të dhëna standardizohen dhe botohen nga INSTAT-i përmes bashkëpunimit tashmë të vendosur me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Avokatin e Popullit. Ky bashkëpunim duhet të zgjerohet për të përfshirë edhe prodhues të tjerë të të dhënave, si Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Zyra e Përmbaramit, dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pas standardizimit të metodologjisë

104 INSTAT (2019). Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri: Vrojtim kombëtar me bazë popullatën, 2018. Shih: <http://www.instat.gov.al/media/6123/publication-violence-against-women.pdf>

105 Për shembull, gjatë periudhës 2007-2018, grupmosha e grave të anketuara u ndryshua, gjë që solli vështirësi për krahasimin e të dhënave të dhunës në familje në vite.

106 Rregullorja (KE) nr. 808/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004 lidhur me statistikat e Komunitetit mbi shoqërinë e informacionit. E disponueshme në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A32004R0808>

për mbledhjen e të dhënave nga INSTAT-i, disa nga të dhënat e prodhuara nga këto institucione mund të përdoren drejtpërsëdrejti për të raportuar mbi treguesit e GAP III të BE-së, për shembull, për “numrin e veprimeve legjislative të ndërmarra në shtetin partner për penalizimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë atë përmes internetit, dhe për ndjekjen penale të autorëve në përputhje me standardet ndërkombëtare”. Tregues të tjerë të GAP III të BE-së mund të llogariten në bazë të informacionit të marrë nga institucione të tjera, si për shembull “% e rasteve të dhunës me bazë gjinore të raportuara në polici që janë çuar në gjykatë dhe që kanë rezultuar në dënimin e autorëve të dhunës, ndarë më së paku sipas seksit”.

4.3. Vlerësimi i ndikimit gjinor

Vlerësimi i ndikimit gjinor është një metodë e standardizuar e BE-së që përdoret rregullisht për vlerësimin *ex ante* të dokumenteve ligjore, planeve të politikave strategjike dhe programeve në proces zbatimi.¹⁰⁷ Një përdorim më i gjerë i vlerësimit të ndikimit gjinor i ndihmon politikëbërëset/politikëbërësit dhe nëpunëset/nëpunësit publikë që të analizojnë dhe parashikojnë ndikimin që do të ketë tek gratë/vajzat dhe burrat/djemetë çfarëdo vendimi i rëndësishëm që shqyrtohet prej tyre, gjë që do të ndihmojë në përmirësimin e masave ekzistuese dhe do të shërbejë si bazë për marrjen e vendimeve për alokimin e buxheteve. Përfundimet e nxjerra nga çdo vlerësim i ndikimit gjinor duhet të vihen në dispozicion në kohë, në mënyrë që të bëhet i mundur ndryshimi i akteve ligjore dhe politikave të tjera përkatëse gjatë fazave të hartimit dhe planifikimit.

“Vlerësimi i ndikimit gjinor mund të kryhet për aktet legjislative, planet e politikave, programet e politikave, buxhetet, veprimet konkrete, projektligjet dhe raportet apo angazhimet për punë kërkimore shkencore. Metodatat e vlerësimit të ndikimit gjinor duhet të zbatohen jo vetëm për politikën që janë në fazën e hartimit; ato mund të zbatohen edhe në kuadër të politikave tashmë ekzistuese. Ato mund të përdoren si në administratë, ashtu edhe nga aktorë të jashtëm; në të dy rastet ato kërkojnë një sasi të konsiderueshme njohurish lidhur me çështjet gjinore.”¹⁰⁸

107 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Në internet]. *Gender Mainstreaming Methods and Tools*. (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor). I disponueshëm në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/toolkits/gender-impact-assessment/what-gender-impact-assessment>

108 Këshilli i Evropës (2004). *Gender mainstreaming: Conceptual framework, methodology and presentation of good practices*. (Integrimi gjinor: Korniza konceptuale, metodologjia dhe prezantimi i praktikave të mira). I disponueshëm në: <https://rm.coe.int/1680596135>

Kohët e fundit, në kuadër të Projektit SANECA të administruar nga GIZ-i, instrumenti i Vlerësimit të Ndikimit Gjinator *ex ante* të BE-së u përshtat për kontekstin shqiptar, me fokus të veçantë mbi përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në të ashtuquajturit “kapitujt e tregut të brendshëm” të BE-së (pra kapitujt 1, 3, 20 dhe 28).¹⁰⁹ Në Kosovë, Agjencia për Barazi Gjinore – që operon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit – përgatiti në vitin 2019 një Manual të posaçëm për Vlerësimin e Ndikimit Gjinator me mbështetjen financiare të Suedisë.¹¹⁰

4.4. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në sektorin e drejtësisë

Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor (BPGJ) është një proces kryesor për përfshirjen e këndvështrimit gjinor në planifikim. Ai “synon të sigurojë që mbledhja dhe alokimi i burimeve publike të kryhet në mënyra të cilat janë efektive dhe kontribuojnë për të çuar përpara barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave”¹¹¹. Është e rëndësishme të theksohet që buxhetimi i përgjigjshëm gjinor nuk do të thotë që të krijohet një buxhet i veçantë për gratë, e as që thjesht të shtohen fondet e shpenzuara në programet për gratë. Shembuj se si mund të zbatohet buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, krahas integritimit gjinor në sistemin e drejtësisë, janë¹¹²:

- Hartimi i objektivave dhe aktiviteteve për trajtimin e hendeqeve gjinore të identifikuara dhe përfshirja e tyre në dokumente strategjike, korniza logjike, marrëveshje financiare dhe buxhete.
- Përfshirja e nismave dhe buxhetimi përkatës për të trajtuar nevojat dhe kufizimet specifike me të cilat përballen gratë ose burrat, ndër të cilat programe për fuqizimin ligjor të grave të pafavorizuara për të pasur akses në drejtësi.

109 GIZ (2022). *Gender Mainstreaming in the Internal Market Chapters of the Acquis - Guidelines and Tools*. (Integrimi gjinor në kapitujt e tregut të brendshëm të acquis – Udhëzime dhe mjete). Shih: https://pubhtml5.com/qzcc/xxqj/Gender_Mainstreaming_in_the_Internal_Market_Chapters_of_the_Acquis/3

110 Republika e Kosovës Agjencia për Barazinë Gjinore (2019). Manuali i Vlerësimit të Ndikimit Gjinator. Shih: <https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Manuali%20p%C3%ABr%20Vler%C3%ABsimin%20e%20Ndikimit%20t%C3%AB%20Barazis%C3%AB%20Gjinore%2054012474.321.pdf>

111 UN Women Asia Pacific [Në internet]. *Gender Responsive Budgeting*. (Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor). Shih: <https://asiapacific.unwomen.org/en/focus-areas/women-poverty-economics/gender-responsive-budgeting>, paragrafi i parë.

112 Platforma e Komisionit Evropian për shkëmbimin e njohurive për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkombëtar [Në internet]. *Thematic brief Justice*. (Dosja tematike e drejtësisë). Gjendet në: https://europa.eu/capacity4dev/public-gender/documents?sort=flag_c4m_og_content_recommend_count&order=asc>erm%5B0%5D=5013&page=22

- ☑ Alokimi i burimeve për integrimin gjinor, ndërtimin e kapaciteteve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet dhe në mënyra që janë përshtatur me nevojat e grupeve të ndryshme të synuara, për shembull, punonjëset/punonjësit e programeve, punonjëset/punonjësit e institucioneve përkatëse vendore të angazhuara/angazhuar në hallka të ndryshme të sistemit të drejtësisë (gjyqtaret/gjyqtarët, avokatet/avokatët, policia, përfaqësueset/përfaqësuesit e autoriteteve të organeve ligjzbatuese), punonjëset/punonjësit e institucioneve të angazhuara/angazhuar në ofrimin e shërbimeve (punonjëse/punonjës të shërbimit shëndetësor, punonjëse/punonjës socialë, etj.), gratë dhe burrat përfituese/përfitues të këtyre shërbimeve.
- ☑ Alokimi i burimeve për aktivitete specifike gjinore, sipas nevojës (për shembull, mbështetje psikologjike për të mbijetuarat e dhunës seksuale).
- ☑ Krijimi i mekanizmave zyrtarë të këshillimit me aktorët e angazhuar në fushën e integritimit gjinor, për të siguruar që gratë të mund të marrin pjesë në caktimin dhe hartimin e objektivave të politikave/ndërhyrjeve.
- ☑ Hartimi dhe alokimi i buxheteve për procese monitoruese me pjesëmarrje dhe ndjeshmëri gjinore, veçanërisht në fazën e zbatimit të programeve, si për shembull, projektimi, mandati dhe vënia në funksionim e gjykatave të dëmshpërblimit në rast konflikti.
- ☑ Përcaktimi i kornizave dhe proceseve të monitorimit të performancës që mund të ngërthejnë përparimin e bërë në drejtim të objektivave që lidhen me gjininë.

Në nismat me mbështetje të drejtpërdrejtë buxhetore:

- ☑ Përfshirja e treguesve gjinorë në marrëveshjet e financimit ndërmjet vendeve donatore dhe atyre përfituese. Për shembull, tregues të dobishëm mund të jenë: “ekzistenca e ligjeve që mbrojnë të drejtat e grave (për shembull, të drejtat sociale, ekonomike, politike dhe seksuale)”; dhe “ekzistenca e protokolleve për zbatimin e ligjeve dhe e mekanizmave për sigurimin e bashkërendimit ndërmjet institucioneve të ndryshme që veprojnë në hallka të ndryshme ligjore”.
- ☑ Respektimi i parimeve të mundësive të barabarta në skemat e menaxhimit dhe krijimi i strukturave të llogaridhënies në lidhje me integrimin gjinor në nivel programesh.
- ☑ Në modalitetin e mbështetjes buxhetore, pagesat duhet të lidhen me përparimin e bërë në arritjen e objektivave gjinore dhe treguesve gjinorë.

- Një pjesë e buxhetit duhet të caktohet posaçërisht për objektiva specifike të barazisë gjinore.

4.5. Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor

Prokurimi publik i përgjigjshëm gjinor (PPPGJ) është prokurim që nxit barazinë gjinore përmes blerjes së mallrave, shërbimeve apo punimeve. Kjo do të thotë që blerëset/blerësit dhe ofrueset/ofruesit e shërbimeve (i) të analizojnë ndikimin që kanë të gjitha veprimtaritë e kontraktuara mbi nevojat, interesat dhe shqetësimet e grave dhe burrave; dhe (ii) të hartojnë dhe t'i realizojnë kontratat në mënyrë të tillë që redukton pabarazitë. PPPGJ-ja nuk nënkupton domosdoshmërisht shpenzime më të mëdha, por kërkon njohuri dhe kapacitete.¹¹³ Prokurimi publik dhe akordimi i kontratave kompanive private që punësojnë fuqi punëtore nga jashtë kompanisë mund të sjellë ndikim pozitiv në rritjen e punësimit në nivel vendor në përgjithësi, dhe në mundësitë e punësimit të grave në veçanti. Në ftesat për propozime që u paraqiten programeve financuese ose në termat e referencës të procedurave të prokurimit publik – ndër të cilat edhe ato për kontraktorët që do të angazhohen për shërbimet në mbështetje të politikave – mund të përfshihen klauzola që përmendin produktet sociale që synohet të arrihen (për shembull, proporcioni i punëtoreve/punëtorëve vendas të kontraktuar sipas kategorisë; proporcioni i grave që do të punësohen; detyrimi për të reduktuar pabarazitë gjinore; respektimi i parimeve të barazisë gjinore, dhe të tjera të ngjashme). Kjo do të sigurojë që projektet dhe shërbimet që marrin fonde të kenë të përfshirë kapacitetet gjinore, t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të grave/vajzave/burrave/djemve, si dhe të kontribuojnë në arritjen e barazisë gjinore.¹¹⁴

Komisioni Evropian shprehimisht në Strategjinë e tij për Barazinë Gjinore për 2020-2025 thekson se 'udhëzimet e Komisionit për prokurimin publik me përgjegjësi shoqërore do të luftojnë diskriminimin dhe do të promovojnë barazinë gjinore në tenderat publikë'.¹¹⁵ Si një nga rezultatet e para të

113 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Në internet]. *Gender Mainstreaming Methods and Tools*. (Metoda dhe mjete për integrimin gjinor). Gjendet në: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>

114 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) (2016). *Gender and Digital Agenda*. (Gjinia dhe agjenda digjitale). Shih: <https://eige.europa.eu/publications/gender-and-digital-agenda>

115 *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions – A Union of equality: Gender equality strategy 2020–2025, COM(2020) 152, 5.3.2020*. (Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve - Një Bashkim i Barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore 2020–2025, COM(2020) 152, 5.3.2020). Gjendet në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0152>

Strategjisë, në prill 2023, Komisioni miratoi rregulla të reja dhe masa detyruese për transparencën e pagave sipas Direktivës për Transparencën e Pagave, e cila trajton në mënyrë specifike pagën e barabartë dhe hendekun gjinor të pagave në kontekstin e prokurimit publik (neni 21).¹¹⁶ Për udhëzime të hollësishme të BE-së mbi PPPGJ-në, shihni: <https://eige.europa.eu/gender-mainstreaming/methods-tools/gender-responsive-public-procurement>.

4.6. Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor

Monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor përdoret për të treguar nëse në një program të caktuar trajtohen përparësitë dhe nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve. Qëllimi është të vlerësohet nëse programi ka ndikimin e parashikuar (ose edhe ndonjë ndikim të paparashikuar) në marrëdhëniet gjinore dhe të përcaktohen aspektet gjinore që duhen integruar në sistemet e monitorimit dhe të vlerësimit. Një monitorim dhe vlerësim i ndjeshëm gjinor që është efektiv duhet të përfshijë si të dhëna cilësore ashtu edhe sasiore që matin ndikimin mbi marrëdhëniet midis gjinive. Pa të dhëna të mjaftueshme është shumë e vështirë të bëhet një analizë e plotë e ndikimit të programeve mbi barazinë gjinore. Kjo do të thotë që të gjitha të dhënat duhet të mblidhen, paraqiten dhe analizohen më së paku të ndara sipas seksit.¹¹⁷ Gjithashtu, rezultatet dhe informacionet e marra nga monitorimi dhe vlerësimi i ndjeshëm gjinor shërbejnë si bazë për ciklet e politikave: ato identifikojnë aspektet për të cilat do të duhet të përfshihen objektiva dhe tregues të barazisë gjinore të formuluar shprehimisht në fazën e planifikimit.

¹¹⁶ *DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL to strengthen the application of the principle of equal pay for equal work or work of equal value between men and women through pay transparency and enforcement mechanisms, 2021/0050(COD), PE-CONS 81/22, 11.4.2023.* (DIREKTIVA E PARLAMENTIT DHE E KËSHILLIT EVROPIAN për të forcuar zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë midis burrave dhe grave nëpërmjet transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit, 2021/0050(COD), PE-CONS 81/22, 11.4.2023). Shih: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-81-2022-INIT/en/pdf>

¹¹⁷ Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) [Në internet]. *Thesaurus* (Fjalor tematik i termave). Gjetet në: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1217?lang=en>

5 REKOMANDIME TË RËNDËSISHME NË SEKTORIN E DREJTËSISË

Ndërhyrjet për integrimin gjinor përfshijnë ngritjen e kapaciteteve për kryerjen e analizave gjinore, si dhe angazhimin aktiv të specialisteve/specialistëve të integritit gjinor përgjatë të gjithë fazave të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive dhe politikave. Për më tepër, politikat ekzistuese në zbatim e sipër duhet të shqyrtohen lidhur me ndjeshmërinë e tyre gjinore (pra, të vlerësohet si i trajtojnë ato pabarazitë gjinore në sektorin/fushën e politikës). Nëse është e nevojshme, këto politika duhet të rishikohen, me qëllim integrimin gjinor në strategjitë sektoriale dhe në strukturat, sistemet dhe proceset e të gjitha institucioneve të përfshira.

TABELA 4

Veprime prioritare për integrimin e objektivave të barazisë gjinore në sektorin e drejtësisë¹¹⁸

Çështja kryesore gjinore	Veprime prioritare
<p>Përhapja e madhe e dhunës me bazë gjinore</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Harmonizimi i plotë i legjislacionit me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë edhe për sa i përket përkufizimit të përdhunimit; ☑ Kryerja e analizave të thelluara dhe marrja e masave për të trajtuar në mënyrën e duhur: (i) shkaqet që ende kufizojnë raportimin e dhunës nga gratë; dhe (ii) numrin e ulët të çështjeve që pranohen nga sistemi gjyqësor për masa mbrojtëse dhe për ndjekjen penale të autorëve të dhunës; ☑ Trajtimi i faktorëve që mund të ndikojnë në denoncimin e dhunës nga gratë, përfshirë stereotipet gjinore dhe normat patriarkale mbizotëruese që normalizojnë dhunën, si dhe i mungesës së besimit në sistemin e drejtësisë; ☑ Marrja e masave për trajtimin e shkaqeve kryesore që pengojnë zbatimin e ligjit dhe pengojnë sistemin gjyqësor të marrë masa mbrojtëse për viktimat e DHBGJ-së, siç janë institucionalizimi i paragjykimeve të forta ndaj grave, mungesa e njohurive për legjislacionin përkatës dhe rolin e policisë, mungesa e burimeve njerëzore, trysnia sociale, dhe frika nga hakmarrja e dhunuesve, sidomos në komunitetet e vogla; ☑ Sigurimi që viktimat e DHBGJ-së, përfshirë ato nga komunitetet e pafavorizuara, të kenë akses me përparësi në ndihmë juridike falas dhe sidomos për përfaqësim ligjor në gjykatë, si në procedura penale ashtu edhe në ato civile;

¹¹⁸ Rekomandimet mbështeten në ato që janë paraqitur në burime të ndryshme, ndër të cilat: Komiteti i CEDAW (2016), Vëzhgime përmbyllëse për Shqipërinë; GREVIO (2017). Raporti fillestar për Shqipërinë; UN Women (2020), Dosja e barazisë gjinore e Shqipërisë; Komisioni Evropian (2021), Raporti për Shqipërinë, 2021; dhe Departamenti i Shtetit i SHBA (2021), Raporti mbi trafikimin e personave.

	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Marrja e masave për zbatimin e parimit të përgjegjësisë civile për të gjitha/gjithë nëpunëset/nëpunësit publikë që nuk përmbushin detyrën e tyre për marrjen e masave të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë ato/ata që nuk zbatojnë urdhrat e mbrojtjes, përmes vendosjes së sanksioneve penale përkatëse; ☑ Marrja e masave që raportet psikologjike që dorëzohen në gjykata të përmbushin kriteret e kërkuara të profesionalizmit dhe objektivitetit; ☑ Garantimi që shpenzimet për sigurimin e raportit të detyrueshëm psikologjik të mos përbëjnë pengesë për aksesin e grave në drejtësi.
<p>Martestat e fëmijëve vazhdojnë të ekzistojnë dhe madje vazhdojnë të tolerohen nga disa gjykata</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Kryerja e një vlerësimi nëse legjislati mbi martestat e fëmijëve (për shembull, Kodi i Familjes) ka mangësi të cilat lejojnë martestat e fëmijëve dhe trajtimi i këtyre mangësive të mundshme ligjore; ☑ Sigurimi që organet e kontrollit të sistemit gjyqësor të ushtrojnë mandatin e tyre ligjor për mbikëqyrjen e praktikave të gjykatave në lidhje me martestat e fëmijëve; ☑ Promovimi i vullnetit politik të vazhdueshëm për t'u dhënë fund martesave të fëmijëve; ☑ Hartimi i kornizave ligjore dhe planeve gjithëpërfshirëse në sektorë të ndryshëm të veprimit me afate dhe objektiva të qarta, dhe integrimi i masave për parandalimin e martesave të fëmijëve.

<p>Numri i ulët i hetimeve dhe ndjekjeve penale për autorët e trafikimit të grave dhe fëmijëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Rritja e përpjekjeve për identifikimin e hershëm të viktimave dhe të viktimave të mundshme të trafikimit, në veçanti në kuadër të emigracionit dhe imigracionit të përzier, dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje dhe i bashkëpunimit ndërkombëtar; ☑ Zgjerimi i juridiksionit të inspektorëve të punës për inspektimin e bizneseve që nuk janë të regjistruara ligjërisht, që mund të përmirësojë identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit; ☑ Trajtimi i formave në rritje të trafikimit të qenieve njerëzore (për shembull, shfrytëzimi seksual në zonat turistike bregdetare), përfshirë përmes forcimit të bashkëpunimit me sektorin privat; ☑ Ofrimi i trajnimeve të posaçme me ndjeshmëri gjinore lidhur me legjislacionin kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe të drejtat e viktimave, për punonjëset/ punonjësit e policisë, prokuroret/prokuratorët dhe gjyqtaret/gjyqtarët, përfshirë edhe udhëzime në lidhje me çështjet e pëlqimit dhe shtrëngimit në kontekstin e punës dhe trafikimit seksual; ☑ Marrja parasysh e mundësisë së miratimit të një ligji të ri për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, në veçanti përmes një skeme kompensimi të financuar nga shteti.
---	---

Mekanizmat kundër diskriminimit dhe gjykatat nuk zbatojnë me efektivitet legjislacionin kundër diskriminimit

- ☑ Rishikimi i Kodit të Procedurës Civile për sa i përket dispozitave që lidhen me barrën e provës në procedura civile që lidhen me praktikat diskriminuese, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar dhe Kodin Procedurës Administrative, që e kanë përmbysur barrën e provës në favor të ankimueses/ankimuesit;
- ☑ Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit në radhët e popullsisë së përgjithshme (përfshirë burrat dhe djemtë) dhe veçanërisht ndër gratë, për legjislacionin mbi barazinë gjinore, legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore;
- ☑ Rritja e kapaciteteve të zyrës së KMD-së, përfshirë të burimeve njerëzore të saj, për të siguruar që institucioni të monitorojë me efektivitet zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit, përfshirë të Ligjit për Barazinë Gjinore, si dhe që të fillojë procedura ex officio në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ☑ Rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin me efektivitet të legjislacionit kundër diskriminimit, përfshirë Ligjin për Barazinë Gjinore;
- ☑ Harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar me Konventën nr. 190 të ILO-s lidhur me Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës, dhe sigurimi i zbatimit të plotë të saj;
- ☑ Mbledhja e të dhënave, përfshirë përmes vrojtimeve, mbi ngacmimin seksual në vendin e punës.

<p>Vendimet e gjykatave në favor të grave në çështje gjyqësore familjare, pronësore, apo çështje të tjera ligjore nuk ekzekutohen në mënyrë të vazhdueshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Intensifikimi i masave ligjore – përfshirë ato të parashikuara në ligjin për dhunën në familje dhe në kodet e procedurës civile dhe penale – mbi ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, së bashku me monitorimin e rregullt të këtyre vendimeve, për të siguruar që rastet e shkeljeve të identifikohen dhe autorët të ndiqen penalisht sipas ligjit; ☑ Rritja e profesionalitetit, kapaciteteve dhe njohurive të punonjësve / punonjësve të përmbarimit mbi legjislacionin shqiptar për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave; ☑ Zbatimi i parimit të përgjegjësisë civile të nëpunësve/ nëpunësve publikë që nuk përmbushin detyrat e tyre për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave.
<p>Gratë e marginalizuara nuk përfitojnë nga sistemi i ndihmës juridike falas, veçanërisht nga ndihma ligjore dytësore</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Sigurimi i burimeve të përshtatshme financiare dhe njerëzore për vijimësinë e shërbimeve ekzistuese të ndihmës juridike falas (NJF) dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të NJF-së dhe i institucioneve që e menaxhojnë atë; ☑ Forcimi i sistemit të ndihmës juridike dytësore, përfshirë përmes lehtësimit të procedurave për sigurimin e aksesit në drejtësi, për të siguruar që gratë viktime të DHBCJ-së dhe gratë nga komunitetet e pafavorizuara të përfitojnë përfaqësim në gjykatë, si dhe përjashtimi i tyre prej shpenzimeve gjyqësore dhe të ekspertëve/ ekspertëve, të cilat janë një barrë e madhe financiare në procedurat civile familjare; ☑ Ofrimi i mbështetjes së përshtatshme financiare për OSHC-të e specializuara në fushën e ndihmës juridike falas, bazuar në kriteret e përcaktuara me ligj; ☑ Marrja e masave që plani i reformës për shpërndarjen territoriale të gjykatave të paraprihet nga një vlerësim ex ante i ndikimit gjinor lidhur me aksesin e grave në drejtësi, në përputhje me metodologjinë e BE-së.

<p>Shumë gra vazhdojnë të mos jenë të regjistruara si pronare të pronave të tyre</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Rritja e ndërgjegjësimit dhe ofrimi i ndihmës juridike për gratë për të siguruar që ato të përfitojnë plotësisht nga dispozitat e përmirësuara që mundësojnë regjistrimin e pasurive të përbashkëta gjatë martesës në emrin e të dy bashkëshortëve; ☑ Rritja e njohurive dhe e nivelit të ndërgjegjësimit të popullsisë së përgjithshme për të drejtat pronësore dhe të trashëgimisë të grave; ☑ Rritja e kapaciteteve të notereve/noterëve, nëpunëseve/nëpunësve të kadastrës dhe gjyqtareve/gjyqtarëve dhe forcimi i monitorimit të zbatimit të legjislacionit, për të siguruar që gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe të jenë të regjistruara si bashkëpronare të pasurisë së përbashkët të familjes.
<p>Mangësitë në statistika gjinore në drejtësi</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☑ Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që prodhojnë të dhëna dhe INSTAT-it, me qëllim llogaritjen e treguesve gjinorë mbi digjitalizimin dhe sektorin e drejtësisë në Shqipëri, të cilët të jenë të harmonizuar me treguesit e BE-së; ☑ Angazhimi në të gjithë hapat e nevojshëm për përgatitjen e treguesve gjinorë në sektorin e drejtësisë, të harmonizuar me treguesit e BE-së dhe në përputhje me metodologjinë e BE-së.



DREJTËSIA

MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT

SHËNDETËSIA

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

DIGJITALIZIMI DHE TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

ADMINISTRATA PUBLIKE

VETËQEVERISJA VENDORE DHE ZHVILLIMI VENDOR

RINIA